



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
SEKTORI I NDIHMËS DHE I PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Bashkia Has

Plani Social Vendor

2024-2027

i rishikuar

Miraturar me VKB Nr.38 datë 22/12/2023

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
I. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE	4
1. Vizioni	4
2. Misioni	5
3. Parimet e Planit Social Vendor	5
II. ANALIZA E SITUATËS	6
1. Kuadri strategjik	6
2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet	7
Vlerësimi i nevojave	7
Të dhënat demografike	7
Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale	7
Individë në familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme	7
Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë.....	7
Punëkërkuarit e papunë.....	9
Individë me aftësi të kufizuar.....	11
Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje	13
Viktima të dhunës në familje	14
Individë/familje në nevojë për strehim social	15
Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi	16
Individë që kanë varësi nga alkooli.....	17
Individë që kanë varësi nga droga.....	17
Persona LGBTIQ+	17
Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve	18
Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta brenda organizatës	18
Analiza e burimeve njerëzore	18
Analiza PESTLE	20
Analiza SËOT	21
III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	23
IV. PLANI I VEPRIMIT	25
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	1
VI. ANEKSI 1 - TABELAT	2



Funded by
the European Union

Ky PlanSocial Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky PlanSocial Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Hasit zbatuar nga GOPA Eorldëide Consultants.

HYRJJE

Bashkia Has përbëhet nga 4 njësi administrative: Krumë, Fajza, Gjinaj dhe Golaj. Bashkia kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Krumës. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 16,790 banorë, ndërsa sipas Regjistrisë Civil ajo numëron një popullsi prej 21,716 banorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Bashkia e Hasit është një zonë kufitare, ku një pjesë e banorëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim apo për arsimim në zonën e Gjakovës në Kosovë, ku gjenden edhe lidhjet historike kulturore dhe ekonomike të krahinës. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 399.62 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 42.01 banorë/km² ndërsa sipas regjistrisë civil densiteti është 53.16 banorë/km². Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit. Hasi gjendet gjithashtu në shtegun turistik malor Theth-Valbonë-Kukës dhe turizmi rural apo malor mund të jetë një perspektivë e mirë ekonomike për këtë zonë..

Nisur nga fakti se ekonomia në rrethin e Hasit varet kryesisht nga burimet nëntokësore të kromit, sfida kryesore mbetet koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve të Bashkisë dhe kompanive që punojnë në këtë sektor. Rigjallërimi i shfrytëzimit të minierave do të sillte rritjen e punësimit dhe mirëmenaxhimin e të ardhurave që merren nga kjo industri.

Analiza demografike e Bashkisë Has vë në dukje rritjen e popullsisë në grupmoshën mbi 65 vjeç, duke sjellë sfida për infrastrukturën shoqërore dhe shëndetësore. Nevojat për kujdes shoqëror shtohen për këtë grupmoshë, ndërkohë një grup tjetër në moshën 50-64 vjeç përballon sfidat e punësimit dhe kërkon mbështetje nga programet sociale. Zvogëlimi i popullsisë së grupmoshës 15-24 vjeç lidhet me emigrimin, ndërsa ende nuk janë zhvilluar shërbime mbështetëse të mjaftueshme në nivel lokal (në nivel bashkie). Kapacitetet financiare të kufizuara dhe mungesa e shërbimeve të integruara sociale janë sfidat kryesore që duhet adresuar. Nevoja për një sistem të integruar të shërbimeve sociale përmban një qasje holistike që siguron përmirësimin e koordinimit dhe efikasitetit në përmbushjen e nevojave komunitare. Ky integrim mund të sjellë shërbime më të personalizuar dhe më të qëndrueshme për të mbështetur individët dhe familjet në nevojë. Analiza e fondeve të Bashkisë Has tregon se 42%¹ e buxhetit të saj shkon për shërbime sociale, i cili përballohet 100% financimi i qeverisë qendrore. Kjo situatë tregon një nivel të lartë varësie të bashkisë nga financimi qendror për shërbimet sociale, pa mundësitë e saj për gjenerim të burimeve të veta dhe potencialisht duke kufizuar autonominë financiare në ofrimin e shërbimeve për komunitetin. Struktura aktuale e shërbimit shoqëror në bashki nuk është e aftë të plotësojë nevojat e grupeve në nevojë. Ka deficencë në personelin e stafit, mungojnë strukturat për të identifikuar grupet në nevojë dhe nevojat e tyre, menaxhimet e rasteve të dhunës dhe fëmijëve në rrezik. Riorganizimi i strukturës së shërbimit shoqëror në bashki është një domosdoshmëri që duhet adresuar menjëherë.

Plani Social Vendor në Bashkinë Has synon të sigurojë një gamë të gjerë shërbimesh për grupet në nevojë duke përfshirë një strategji të bashkëpunimit midis enteve të ndryshme, si institucionet lokale dhe rajonale, organizatat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bizneset lokale për të përmirësuar shërbimet sociale. Përmes planifikimit dhe implementimit të veprimeve të përshtatshme, synohet të reduktohet dhe të lehtësohet varfëria në Bashkinë Has, duke përmirësuar shërbimet për familjet, fëmijët dhe individët e varfër dhe të përfshirë

¹ Drejtoria e Finances Bashkia Has

në varfëri ekstreme. Synimi është të krijohet një ambient më i mirë për personat me aftësi të kufizuara, duke integruar sistemin e pagesave në shërbimet e përfshira. Kjo synon të inkurajojë integrimin e tyre në shoqëri dhe ekonomi. Qëllimi është të sigurohen shërbime të kujdesit shoqëror me standarde për të gjitha grupet në nevojë në territorin e Bashkisë Has përmes fuqizimit, riorganizimit dhe koordinimit të shërbimeve sociale.

Plani synon të paraqesë një vizion afatgjatë dhe një rrugë të qartë drejt mbrojtjes sociale për këtë bashki deri në vitin 2027. Ai (plani) është produkti i konsultimeve të thelluara dhe diskutimeve me profesionistë, ekspertë dhe aktorë të fushës së mbrojtjes sociale. Plani përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë dhe ofron një kornizë monitorimi për të siguruar respektimin e standardeve të cilat do të garantojnë një cilësi më të mirë të jetës për njerëzit në nevojë. Gjithashtu metodologjia është bazuar të metoda e vlerësimit me pjesëmarrje, përmes kombinimit të intervistave me aktorët përgjegjës dhe profesionisteve të fushave të: shërbimeve sociale, shëndetësore, arsimit, punësimit dhe formimit profesional, sigurisë publike, etj. me mbledhjen e të dhënave statistikore dhe informacionit të disponueshëm në nivel lokal.

Përveç kësaj, procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë bëri të mundur që nëpërmjet takimeve dhe fokus grupeve me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) të merreshin të dhëna specifike mbi shërbimet që ofron Bashkia Has. Gjithashtu u zhvilluan konsultime edhe me përfaqësues të Institucioneve lokale dhe dy organizatave, të cilët veprojnë në territorin e bashkisë, me fokus ofrimin e shërbimeve sociale për target grupe të ndryshme. Në mënyrë të hollësishme, përgatitja e Planit ndoqi hapat si më poshtë:

- Një vështrim i plotë i politikave vendore lidhur me shpërndarjen e shërbimeve sociale;
- Një inventar i shërbimeve të ofruara nga organizata dhe shoqata që ofrojnë shërbime sociale në Bashkinë e Hasit;
- Identifikimi i grupeve të mundshme në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.
- Identifikimin e gjendjes aktuale të tipave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar mbi shportën e shërbimeve.
- Identifikimin e roleve të strukturave ekzistues dhe njërive të nevojshme për bashkëpunim për hartimin e Planit të ri Social Vendor, dhe monitorimit të tij në vazhdimësi. Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale;
- Konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor ;
- Konsultim me përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime për komunitetin.

Metodologjia është hartuar duke marrë në konsideratë Bashkinë e Hasit si njësi më vete me specifikat e nevojave për shërbime sociale, si dhe me specifikat për zhvillimin e shërbimeve në të ardhmen. Metodologjia ka parashikuar gjithashtu mbledhjen e të dhënave sasiore (aty ku disponohen) për secilin target grup dhe shërbimet sociale që ofrohen.

I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.Vizioni

Vizioni për Planin Social të Bashkisë synon të krijojë një mjedis përfshirës dhe të barabartë për të gjithë qytetarët duke përmirësuar kushtet sociale, mbështetur familjet, ndihmuar grupet në nevojë, inkurajuar pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse dhe të ndërtuar një qasje të qëndrueshme ndaj zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit. Ky vizion synon të

krijojë një mjedis ku të gjithë të kenë mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe të jetojnë në një mjedis të drejtë dhe të përmirësuar për të gjithë.

2. Misioni

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Has do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJQ-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

3. Parimet e Planit Social Vendor

Plani Social Vendor, Bashkia Has, synon të sigurojë një përfshirje të gjerë dhe të barabartë të të gjithë grupeve dhe individëve të disavantazhuar, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke adresuar sfidat sociale si varfëria, pabarazia, dhe mungesa e aksesit në shërbime të nevojshme. Disa nga parimet dhe hapat që përfshihen në këtë plan janë:

Përfshirja sociale: Sigurimi i aksesit të barabartë për të gjithë në shërbime dhe mundësi, pa dallim dhe përfshirja e të gjithë komuniteteve.

Respektimi i të drejtave të njeriut: Bazuar në dinjitetin e individëve dhe sigurimin e jetesës së tyre dhe përfshirje në shoqëri.

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Ndërtimi i partneriteteve për të arritur qëllimet sociale me organizata jo-qeveritare, sektorin privat dhe aktorët shoqërorë.

Trajtimi i varfërisë dhe pabarazisë: Adresimi i sfidave të varfërisë dhe pabarazisë duke ofruar mbështetje për grupet më të prekura.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Përparimi drejt një qëllimi të zhvillimit social vendor të qëndrueshëm duke pasur parasysh mirëqenien afatgjatë të familjeve dhe individëve.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale: Ruajtja e të dhënave personale të individëve në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qeverisja e mirë: Sigurimi i transparencës, pjesëmarrjes së qytetarëve, dhe llogaridhënie të plotë në proceset vendimmarrëse.

Universaliteti dhe mosdiskriminimi: Garancia e aksesit të barabartë dhe luftimi i çdo forme të diskriminimit, duke siguruar një mjedis të barabartë për të gjithë.

Hapat specifikë të veçantë për të realizuar këto parime përfshijnë:

- Financimi i Fondit Social për shërbime sociale.
- Hartimi dhe zbatimi i politikave lokale të mbështetura në respektimin e të drejtave të njeriut, të fëmijëve dhe barazisë gjinore.
- Sigurimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara.

- Ndërtimi i shërbimeve sociale të përshtatura në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive financiare.
- Implementimi i politikave që inkurajojnë pjesëmarrjen e grupeve të interesit dhe monitorimin e zbatimit të planit.

II. ANALIZA E SITUATËS

1. Kuadri strategjik

Plani social vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAË

Dokumentet strategjike

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendorë;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendorë”;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:

- Strategjia Territoriale Bashkia Has;
- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Has.

2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet

Vlerësimi i nevojave

Të dhënat demografike

Numri i popullsisë në Bashkinë Has në vitin 2023 sipas Gjendjes Civile është 21,800 banorë, 50.45% e të cilëve janë gra dhe vajza. 18.5% e popullsisë së Bashkisë banojnë në qytet dhe 81.65% e popullsisë banojnë në fshatra. Gjatë viteve 2020-2023 popullsia është ulur me 95 banorë ose e thënë ndryshe, në vitin 2023 Bashkia Has regjistron 0.43% banorë më pak se viti 2020. Në këto 4 vitë, njësitë Krumë dhe Gjinaj paraqesin nivel më të lartë të uljes të popullsisë me respektivisht 42 dhe 35 banorë më pak në vitin 2023, ndërsa 2 njësitë e tjera Fajza dhe Golaj kanë një ulje më të vogël, respektivisht 8-10 banorë. Dinamike paraqitet trendi i ndryshimit të popullsisë sipas grupmoshave, konkretisht rezultojnë: një rënie të popullsisë në grupmoshat 0-19 vjeç (3.75%) dhe 20-29 vjeç (4.87%), por një trend në rritje për grupmoshat 30-49 vjeç (1.35%), grupmoshat 50-59 vjeç kanë ulje (2.25%), ndërsa grupmoshat 60-69 vjeç dhe mbi 70 vjeç kanë një rritje prej 5.78% dhe 4.58% përkatësisht².

Rënia e numrit të të rinjve në grupmoshat 0-19 vjeç dhe 20-29 vjeç sugjeron një tendencë të shqetësuese për potencialin e rënies së gjeneratave të reja. Kjo rënie e të rinjve mund të interpretohet si një shenjë e emigracionit të tyre jashtë territorit apo largimit nga zona për shkaqe të ndryshme. Ulja e grupmoshave 50-59 vjeç tregon për një proces të plote të plakjes së popullsisë. Ky grup është në një fazë kur njerëzit fillojnë të ndihen më pak të gatshëm për të bërë lëvizje ose të kërkojnë ndryshime të mëdha në jetën e tyre, ndaj edhe rënia e tyre është më e kuptueshme. Rritja e grupmoshave 60-69 vjeç dhe mbi 70 vjeç (5.78% dhe 4.58% përkatësisht) sugjeron një rritje në moshën e popullsisë, gjë që sjell nevojën për kujdes të shtuar shëndetësor dhe social. Profesionistët vendorë shprehin se faktorë si emigracioni, migrimi brenda vendit dhe numri i lindjeve janë përgjegjës për këto ndryshime të strukturës së popullsisë në Bashkinë Has.

Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale

Individë në familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë

Ndihma Ekonomike (NE) Bazuar në ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, (nëpërmjet transfertave të kushtëzuara nga qeveria) Bashkia Has mbështet nëpërmjet një pagese mujore në *cash*, me Ndihmë Ekonomike (NE) 1689 familje, që përbëjnë rreth 38.9% të popullsisë së kësaj bashkie³. Numrin më të madh e zënë familjet e Njësisë Administrative Golaj. 33.75% e familjeve përfituese të NE i përkasin Njësisë Administrative Krumë, 36.83% i përkasin familjeve të NjA Golaj, 21.49% i përkasin NjA Fajzë dhe 7.93% i përkasin NjA Gjinaj. Njësitë Administrative Golaj dhe Krumë që kanë edhe numrin më të madh të familjeve në NE prezantojnë një trend në rritje të numrit të familjeve përfituese të NE, ndërsa Njësië Administrative Fajzë dhe Gjinaj rezultojnë me një trend në ulje të numrit të familjeve përfituese. Numri i familjeve përfituese të NE gjatë viteve 2020-2023 ka qenë dinamik. Në shtator 2023 numri i familjeve përfituese të NE është 0.18 % më i lartë se në vitin 2020. Trend rritës prezanton edhe fondi i NE, i cili në vitin 2023 rritet me 56.67% në krahasim me vitin 2020. Kjo është shoqëruar me rritje të masës mesatare

² Tabela nr 1 dhe 2

³ Tabela nr 3

tëndihmës ekonomike për familje. Në vitin 2023 masa mesatare e NE për familje është rreth 9779 lekë(56.38%) në krahasim me 6253 lekë që ishte në vitin 2020. Vërehet nivel i lartë e raportit familje përfituese të NE/familjet aplikuese për NE në vite. Në 2023, mbi 99 % e familjeve aplikuese përfitojnë NE kundrejt 98% e familjeve aplikuese përfituese në vitin 2020.76% e familjeve përfituese të NE janë gra dhe vajza k/familjare (numrin më të lartë e ka NjA Golaj me , 22.6 % e familjeve kanë një anëtar të saj PAK⁴. Nuk evidentohen familje rome/egjiptiane përfituese të NE.

Familjet me numrin më të madh të anëtarëve janë ato me 5 anëtarë e më lart, duke zënë një pjesë të rëndësishme të përqindjes së totalit të familjeve përfituese (31.29% për familjet me 5 anëtarë, 19.42% për familjet me 6 anëtarë dhe 13.78% për familjet me mbi 6 anëtarë). Ky grup familjesh ka ndikim të konsiderueshëm në strukturën e popullsisë që përfiton ndihmë sociale, dhe gjithashtu ka nevoja më komplekse për kërkesat e tyre në fushën sociale. Në anën tjetër, familjet me numrin më të ulët të anëtarëve janë ato me 2-3 anëtarë (2.79% dhe 8.55% përkatësisht). Kjo tregon se një pjesë e mirë e familjeve të përfituesve të ndihmës sociale janë me madhësi të moderuar or jo të mjaftueshme për të pasur kapacitetin e plotë të mbulimit të nevojave të tyre. Familjet me 4 anëtarë (24.05%) tregojnë një pjesë të konsiderueshme, ndërsa ato me 1 anëtar përbëjnë një përqindje të vogël (0.12%), pothuajse e papërfillshme në totalin e përfituesve të ndihmës sociale⁵.

Krahas familjeve përfituese të NE-sënë Bashkinë Has, nga kjo skemë, në shtator 2024 mbështeten: a) 3 viktimitë të dhunës në krahasim me 0 viktima të dhunës të mbështetura në 2020; b) vetëm 1 familje me trinjakë gjatë 4 viteve: e) 4 fëmijë në shërbim kujdestarie në krahasim me 4 familje në vitin 2020⁶.

Pjesë integrale e pagesës së NE janë subvencionet⁷ shtesë të ofruara nga Bashkia Has për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre në masën deri në 400 lekë shtesë aplikohen çdo muaj. (Pagesa per femijet qe ndjekin arsimin 9 vjeçar pjese e skemes se NE-se subvencionohen me 300 leke,

Gjatë fokus grupeve me profesionistë të Bashkisë Has doli në pah se:

- 64.48% e familjeve përfituese të NE janë familje me 5 anëtarë e lart dhe pagesa e NE në mbi 90% të rasteve është e vetjma e ardhur për familjen, por që nuk mbulon të gjitha nevojat e familjes.
- Gjatë periudhës së dimrit gjendja e familjeve përfituese të NE vështirësohet edhe më shumë dhe kërkohet një mbështetje shërbime, paketa ushqimore e të ngjashme.
- Është i lartë numri i familjeve që kanë mbi 5 vite që përfitojnë NE. Largimi i tyre nga skema e NE drejt skemave të punësimit nëpërmjet zbatimit të “Programit të Daljes” rezultoi i vështirë.

*Fondi 6%:*Një tjetër skemë mbështetëse për familjet në nevojë është përfitimi i NE nëpërmjet fondit 6%, financim i fondeve qeveritare. Aktualisht, kjo skemë ofron ndihmë në CASH për rreth 162 familje, një shifër që është pothuajse e ngjashme me numrin e familjeve që përfituan në vitin 2021. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Has ka miratuar disa kritere për përfitimin nga ky fond, duke përfshirë:

⁴ Tabela 5 Anekse

⁵ Tabela 6 Anekse

⁶ Tabela 4 Anekse

⁷Ky subvencion përllogaritet shtesë në pagesën e NE

- Selektimi i familjeve në nevojë nga lista e aplikimeve të regjistruara brenda tre muajve të fundit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për Ndhimën Ekonomike, duke përzgjedhur ata që nuk kanë fituar në mënyrë automata nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh.
- Përzgjedhja e aplikuesve që kanë paraqitur dokumentacion të plotë për aplikimin e tyre.
- Prioritet do të jepet familjeve me nevoja sociale-ekonomike të shprehura, duke përfshirë familjet pa të ardhura, familjet me kryefamiljare në vështirësi ekonomike, dhe familjet që kanë anëtarë me paaftësi ose invalide.
- Familjet me të ardhura minimale si pensionistët ose ata që marrin pagën minimale do të konsiderohen gjithashtu për këtë fond.

Duke bërë një përmbledhje të të dy skemave rezulton se 39.66% e popullsisë së Bashkisë Has përfiton një ndihmë financiare në *cash*.

Sfidat në lidhje me zbatimin e skemës së përfitimit të transfertave të NE janë:

1. Shenjëstrim më i mirë i familjeve në përfitimin e NE nëpërmjet vlerësimit të situatës social ekonomike të tyre, intervistimit dhe vizitave periodike në shtëpi të familjeve aplikuese apo përfituese të NE-së.
2. Rritja e kapaciteteve të stafit të Bashkiaë Has për administrimin dhe monitorimin e Ndhimës Ekonomike (NE) duke investuar në trajnime që mund të orientojnë dhe lehtësojnë detyrat e punonjësve të bashkisë, përmirësuar kështu efikasitetin e tyre.
3. Integrimi i shërbimeve për përfituesit e Ndhimës Ekonomike (NE), duke zhvilluar programe që ofrojnë shërbime të koordinuara në përgjigje të nevojave të tyre në arsim, strehim, shëndetësi dhe ndihma në natyrë, nëpërmjet një komunikimi dhe koordinimi të suksesshëm mes departamenteve të ndryshme të bashkisë për të arritur këtë qëllim.
4. Ndërgjegjësimi i opinionit publik për Ndhimën Ekonomike (NE) duke organizuar fushata informuese dhe duke përdorur mediat sociale për të transmetuar mesazhet e rëndësishme, duke bashkëpunuar me organizata jo-qeveritare dhe mediat lokale, si dhe duke përdorur aktivitete publike për të diskutuar për NE-në dhe për impaktin e saj në komunitet për të rritur përkrahjen dhe kuptimin për këtë skemë.

Punëkërkuesit e papunë

Sipas të dhënave të marra nga Shërbimet e Punësimit rezulton se në Bashkinë Has janë të regjistruar rreth 1318 persona, punëkërkues të papunë (PUPA), 2.89% e popullsisë në moshë madhore e aftë për punë. Nga analiza e PUPA-s rezulton se 0.04% të Pupa-s janë të rinj 15-19 vjeç, 0.97% janë pupa të grupmoshës 20-24 vjeç, 1.34% janë pupa të grupmoshës 25-29 vjeç, 21.55% janë pupa të grupmoshës 30-39 vjeç dhe 54.85% janë pupa mbi 40 vjeç.

Duke e analizuar PUPA-n sipas grupmoshës në nivel popullsie, rezulton numri i personave tëregjistruar si punëkërkues të papunë është shumë i ulët. Ai varion nga 0.04% (grupmosha 15-19) që përbën % më të ulët deri 54.85% (grupmoshës mbi 40 vjeç) që përbën % më të lartë.

Grupmosha	Punë kërkues të papunë		
	Numër	Në % nga totali I PUPA	Në % me totalin sipas grupmoshës së popullsisë
15-19 vjeç	29	1.97%	0.04%
20-24 vjeç	125	8.50%	0.97%
25-29 vjeç	157	10.68%	1.34%
30-34 vjeç	145	9.86%	1.33%
35-39 vjeç	139	9.46%	2.57%
40-44 vjeç	199	13.54%	3.54%
45-50 vjeç	177	12.04%	5.77%
mbi 50 vjeç	347	23.61%	4.71%
Totali	1318		

Disa nga karakteristikat e punëkërkuesve të papunë (pupa) për BashkinëHas:

- 0.07% e tyre janë pa arsim, 0.68% kanë arsim fillor, 55.78% kanë arsim 9 vjeçar, 27.07% kanë arsim të mesëm të përgjithshëm, 1.43% kanë arsim të mesëm profesional dhe 5.16% kanë arsim të lartë dhe pasuniversitar.
- 50.68% janë gra dhe vajza, 45.87% e të cilave janë kryefamiljare (668 gra dhe vajza të regjistruara si të papuna dhe punëkërkuese, 519 prej tyre kryefamiljare)
- 68.89% janë anëtarë madhorë, në moshë punë të aftë për punë, të familjeve përfituese të NE.
- 2.12% i përkasin grupeve vulnerabel (2 romë dhe egjiptianë, 13 persona me aftësi të kufizuar dhe 13 emigrantë të kthyer).

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkitë nuk ofrojnë shërbime të punësimit apo formimit profesional. Megjithatë, bazuar në Programin e Daljes dhe marrëveshjeve dypalëshe midis Bashkive dhe Zyrave të Punës, bashkitë janë përfshirë në përgatitjen dhe informimin e anëtarëve madhorë të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike (NE), që janë të aftë për punë, për mundësitë e punësimit dhe formimit profesional. Gjatë vitit 2023, administratorët shoqërorë të Bashkisë Has, kanë ofruar orientime për këta anëtarë të familjeve përfituese të NE drejt skemave të punësimit dhe formimit profesional. Megjithatë, një numër i vogël i familjeve kanë përfituar nga këto shërbime, veçanërisht në qytete, ku rreth 20 persona janë punësuar. Pas analizës nga fokus grupet me administratorët shoqërorë dhe drejtuesit e Zyrës së Punës në Bashkinë Has, rezultoi se ka qenë vështirë për të përfituar nga Programi i Daljes disa kategori, si: i) anëtarët e familjeve përfituese të NE që jetojnë në zona rurale (për shkak të largësisë); ii) nënat me fëmijë të vegjël (për shkak të mungesës së çerdheve dhe numrit të kufizuar të kopshteve); iii) anëtarët e familjeve përfituese të NE në grupmoshën 45 vjeç e lart; iv) individët me aftësi të kufizuara të aftë për të punuar dhe që dëshirojnë të punojnë.

Përdorimi i inovacionit dhe krijimi i mjedisit të përshtatshëm të punës mund të ndihmojë në shtrirjen e mundësive për punësim dhe formim profesional për familjet përfituese të Ndhmës

Ekonomike, duke i bërë ato më të arritshme dhe më të përshtatshme për nevojat e tyre specifike. Sfidat në nxitjen e familjeve të NE të largohen nga skema pasive e përfitimit të NE drejt skemave të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional është:

1. Zbatimi i “**Programit të Daljes**” duke u fokusuar tek anëtarët e aftë për punë të familjeve që kanë mbi 5 vite që përfitojnë pagesë të NE-së, duke i integruar ato në tregun e punës dhe jetën shoqërore.
2. Përdorimi i inovacionit dhe teknologjisë: Në përpjekje për të adresuar sfidën e largësisë në zonat rurale, mund të shfrytëzohen mjetet e teknologjisë për ofrimin e trajnimeve dhe informacionit në distancë. Përdorimi i platformave online, kurseve e-learnimi dhe trajnimeve virtuale mund të bëjë që edukimi dhe formimi profesional të jetë më i arritshëm për anëtarët e këtyre familjeve.
3. Mbështetja financiare për mundësimin e aksesit në trajnime profesionale të personave përfitues të NE.
4. Krijimi i mjedisit të përshtatshëm të punës: Për të adresuar sfidën e kufizimeve për nënat me fëmijë të vegjël dhe personat me aftësi të kufizuara, mund të ndërmerren hapa për të rritur numrin e strukturave të kujdesit dhe të përmirësuar mundësitë e tyre për punësim. Investimet në rritjen e numrit të çerdheve dhe kopshteve ose krijimi i programeve të fleksibilitetit të punës mund të përmirësojë mundësitë e tyre për të punuar dhe përfituar nga trajnimet profesionale.

Individë me aftësi të kufizuar

Të dhëna për përfitimin e Pagesës për shkak të Aftësisë së Kufizuar sipas Njërive Administrative

Bazuar në legjislacionin shqiptar⁸, sipas statistikave të BashkisëHas, në Shtator 2023 numri i personave që janë njohur zyrtarisht që kanë një aftësi të kufizuar në Bashki është 914⁹(4.19 % e popullsisë së bashkisë). Nga këta, 527 persona janë invalidë pune që përfitojnë si nga pagesat e sigurimeve shoqërore ashtu edhe nga pagesat shtesë të skemës së mbrojtjes sociale dhe 387 fëmijë e të rritur, që marrin pagesat e aftësisë së kufizuar dhe përfitime të tjera në sistemin e mbrojtjes sociale. Nga këta të fundit, 124 persona (32.04%) marrin edhe pagesë për të mbuluar shërbimin e ndihmësimit personal që më parë është quajtur shërbimi i kujdestarisë¹⁰.

Në vitin 2023 numri i personave përfitues të AK është rritur me 7.91% (në vitin 2023 trajtohen mesatarisht në muaj 914 persona me AK kundrejt 847 personave të trajtuar në vitin 2021). Raporti përfitues i pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar qytet/fshat është më i madh në njësitë administrative se në Krume, ato variojnë nga 56-62% më shumë PAK banorë në zona rurale. Bashkia nuk gjeneron të dhëna gjinore për PAK. Të ndarë sipas kategorive përfituese, 5.03% e personave përfitues të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar janë para dhe tetraplegjikë, 3.94% të verbër, 57.66% invalidë punë, 33.37% PAK sipas vlerësimit bio-psiko-social.

Vërehet numër i ulët i numrit të personave me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë në BashkinëHas. Vetëm 0.72% e tyre ndjekin arsimin e mesëm (shikohet njëtrënd

⁸ Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;

⁹ Tabela 7 Anekse

¹⁰ Tabela 11 Anekse

rritje i personave të verbër që ndjekin arsimin e mesëm) dhe 0.63% e tyre ndjekin arsimin e lartë(ky nivel arsimor ndiqet vetëm nga kategoria e PAK të cilët vlerësohen nga KSHVBPS).¹¹

Numri i personave përfitues të ndihmës personal gjatë vitit 2023 është rritur vetëm për 1 person, në tre vite ka qenë pothuajse i njëjtë 123 dhe në vitin 2023 numri u rrit në 124.

Persona me aftësi të kufizuar, përfitues të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar, sipas kategorisë përfituese janë:

1-Paraplegjike–tetraplegjikë:

- 46janë persona para dhe tetraplegjikë. (5.03% e totalit të përfituesve të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar),
- 100% e tyre kanë ndihmës personal,
- Asnjë nuk ndjek arsimin e mesëm apo të lartë.

2-Të verbër:

- 36janë persona të verbët (3.94% e totalit të përfituesve të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar),
- 8 prej tyre kanë ndihmës personal,
- Asnjë i verbër nuk ndjek arsimin e mesëm apo të lartë.

3-Invalidë pune:

- 527 janë persona invalidë punë që përfitojnë NE (57.66% e totalit të përfituesve të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar),

4-Persona me Aftësi të Kufizuar:

- 305 janë persona që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar (33.37% e totalit të përfituesve të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar)të vlerësuar të paaftë nga komisioni multidisiplinar i vlerësimit të aftësisë së kufizuar,
- 70 prej tyre kanë ndihmës personal tëherëpashershëm/përherëshëm,
- Vetëm 9 prej tyre ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë (respektivisht 4 ndjekin arsimin e mesëm dhe 5 prej tyre arsimin e lartë).
- 132 janë të mitur të grupmoshës 0-18 vjeç, 173 janë të rritur të grupmoshës 19 vjeç e lart.
- 168 janë PAK mendorë, 137 janë PAK fizikë

Menaxhimi i skemës së përfitimit të AK realizohet nga Sektori i shërbimeve sociale dhe ndihmes ekonomikedhe Inspektori i ndihmes ekonomike (administratorët shoqërorë) në çdo njësi administrative.

Ndërsa vlerësimi i aftësisë së kufizuar me modelin bio-psiko-social realizohet nga Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar të ngritura pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, roli i Bashkisë Hasnë këtë proces orientohet drejt: i) zbatimit të rekomandimeve të komisionit shumëdisiplinar për hartimin e planeve zhvillimore një vjeçare për personat me aftësi të kufizuar dhe ndjekjen e tyre; ii) garantimin e shërbimeve shoqërore drejt jetesës së pavarur të PAK me kufizim të lehtë të AK si dhe mbështetje dhe orientim i tyre në tregun e punës dhe formimin profesional; iii) vlerësimin e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet verifikimit të cilësisë së kushteve të jetesës së personit me aftësi të kufizuar çdo tre muaj (pra 4 herë në vit). Burimet

¹¹ Tabela 9 dhe 10 Aneksë

njerëzore të Bashkisë Has për zbatimin e detyrave funksionale ligjore për AK, aktualisht janë të pamjaftueshme.

Sfidat e Bashkisë Has në zbatim të aftësisë së kufizuar lidhen me:

- 1- Mundësitë në ofrimin e shërbimeve shoqërore për të gjithë personat me aftësi të kufizuar të vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të përfituar shërbime shoqërore;
- 2- Institucionalizimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel lokal për mbështetjen dhe trajtimin e personave me aftësi të kufizuar sipas rekomandimeve të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
- 3- Rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkisë (administratorëve shoqërorë në lagje dhe njësitë administrative) për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve njëvjeçare zhvillimore për personat me aftësi të kufizuar
- 4- Përfshirja në përshkrimin e detyrave të specialistit për AK në rregulloren e Bashkisë Has.
- 5- Ofrimin e kushteve të përshtatshme të punës së administratorit shoqëror për zbatimin e kërkesave ligjore në lidhje me ndjekjen dhe monitorimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet verifikimit në shtëpi
- 6- Ndërgjegjësimi komunitetit rreth AK si një e drejtë e individit dhe promovimi i jetesës së pavarur për PAK.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje

Sipas të dhënave nga Gjendja Civile të përpunuara me të dhënat e INSTAT, numri i fëmijëve në Bashkinë Has është rreth 4,857 fëmijë, të cilët përbëjnë 22.28% të popullatës (Njësia Administrative Golaj ka numrin më të madh të fëmijëve). 21.45% e totalit të fëmijëve i përkasin grupmoshës 0-4 vjeç, 24.93% i përkasin grupmoshës 5-9 vjeç, 25.65% i përkasin grupmoshës 10-14 vjeç dhe 27.97% i përkasin grupmoshës 15-19 vjeç. Në raport me vitin 2020, numri i fëmijëve ka një rënie 3.76%, kjo për shkak të uljes së numrit të lindjeve dhe emigrimit të popullatës jashtë vendit.

Në Bashkinë Has mungojë çerdhet publike/ jo publike për fëmijët e grupmoshës 0-4 vjeç.

606 fëmijë të grupmoshës 4-6 vjeç , familjet e të cilëve përfitojnë NE marrin shërbim në 9 kopshtet e Bashkisë Has (4Krumë, 3 Golaj, 1 Fajzë dhe 1 Gjinaj)

2,516 fëmijë ndjekin arsimin bazë nënëntë shkolla 9 vjeçare, (1712 vajza).

702 e fëmijëve 16-19 vjeç ndjekin arsimin e mesëm, në 2shkolla të mesme (453 vajza).

135 fëmijë 0-18 vjeç përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar, 18 fëmijë me AK të grupmoshës 6-15 vjeç prej tyre ndjekin arsimin e detyrueshëm 9 vjeçar. 2 fëmijë me AK të grupmoshës 16-19 vjeç ndjekin arsimin e mesëm.

42 fëmijë me AK jetojnë në familje përfituese të NE.

1579 fëmijë jetojnë në familje në nevojë të cilat përfitojnë NE. 1131 prej tyre janë fëmijë të grupmoshës 0-15 vjeç dhe 448 fëmijë të grupmoshës 16vjeç e lart.

4 fëmijë përfitojnë nga shërbimi i kujdestarisë dhe përfitojnë një pagesë mujore 9000 lekë.

Gjatë vitit 2023, fëmijë në Bashkinë Has mungojnë shërbime shoqërore publik dhe jo publike për fëmijë.

Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Has, gjatë vitit 2023, evidenton 1475 fëmijë në nevojë (Aneksi 1 Tabela 12)

Në rregulloren e Bashkisë Has mungon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës/Punonjësi për Mbrojtjen e fëmijëve. Përgjegjësi i Sektorit i shërbimeve sociale dhe ndihmes ekonomike luan rolin e MJF/PMF për fëmijët në 4 njësitë administrative të bashkisë që nga evidentimi i nevojave të fëmijëve, sistemimin e tyre në qendrat rezidenciale, kur është e nevojshme, evidentimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, koordinimin e GT dhe menaxhimin e rastit. Ky sektor nuk disponon të dhëna përfëmijë për vitet 2021-2022. Mungesa e të dhënave vjen si pasojë e mungesës së strukturave në mbrojtje të fëmijëve dhe Njësia së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave. Sektorit ka staf të pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e fëmijëve në të gjithë Bashkinë. Përgjithësisht ofron shërbim kryesisht në Njësia Administrative Krum dhe mbulon rastet emergjente për fëmijët në njësitë e tjera. Bashkëpunimi ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale është funksional vetëm për menaxhimet e rasteve. Mungon shkëmbimi i informacionit periodik për problematikat e fëmijëve.

Sfidat e Bashkisë Has

1. Bashkia Has synon zhvillimin e gamës së gjerë të shërbimeve sociale për fëmijët në vitet 2024-2027, duke përmirësuar mbështetjen e tyre sociale në këtë periudhë kohore.
2. Ngritja e sektorit të Mbrojtjes Sociale për grupet në nevojë do të nxisë ngritjen e shërbimeve për të siguruar trajtimin dhe mbrojtjen e 1475 fëmijëve në nevojë në mënyrë më efektive për të përmirësuar kujdesin dhe mirëqenien e tyre.
3. Konsolidimi i roli të PMF në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë është në fokus, duke organizuar takime informuese me aktorët lokale dhe komunitetin për të përmirësuar kujdesin për fëmijët në nevojë.
4. Riorganizimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale, përfshirë emërimin e NJMF dhe PMF, ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të rasteve të fëmijëve për të ofruar mbrojtje dhe kujdes efektiv.
5. Buxhetimet për menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për punën e PMF janë në plan, për të siguruar një kujdes më efektiv dhe të përshtatshëm.
6. Zgjerimi i shërbimeve për fëmijët dhe fuqizimi i të rinjve është në fokus, duke përmirësuar qasjen dhe mbështetjen për këtë grup.
7. Ngritja e çerdheve në çdo njësi administrative është një synim, për të siguruar një akses më të gjerë dhe më të lehtë për fëmijët në kopshte dhe çerdhe.

Viktima të dhunës në familje

Bashkia Has sapo është strukturuar koordinatori vendor për dhunën që u përgjigjet rasteve të dhunës ndaj grave e vajzave në territorin e Bashkisë Has. Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje vepron në nivel vendor konform Protokollit të Menaxhimit të Rasteve në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar dhe VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Gjatë viteve 2020, 2021, 2022 dhe 2023 ka trajtuar rreth 18 raste të dhunës në familje, paraqitur në tabelën 13, Aneksi 1.

Numri më i lartë i rasteve të dhunës rezulton në NJA Fajzë. Sipas të dhënave për periudhën 2020-2023, nga NJA Gjinaj nuk ka asnjë raportim për dhunë në familje.

Bazuar legjislacionit shqiptar rastet e pajisura me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), dhe/ose Urdhër Mbrojtje (UM) përfitojnë NE prej 9900 lekësh. Në fakt të gjitha rastet me UMM/UM (në vite) në 4 Njësitë Administrative nuk rezultojnë të kenë përfituar pagesë/NE. Specialisti që mbulon çështjet e dhunës e shpjegon këtë situatë me faktin se viktimat: i) nuk kanë informacion mbi ndihmën; ii) nuk janë të interesuara për pagesën; iii) ose janë larguar në bashki të tjera ose jashtë shtetit.

Sipas diskutimeve me profesionistë në Bashkinë Has në zonat rurale të Bashkisë ka dhunë në familje, por ajo mbetet e paraportuar për shkak të mentalitetit, mungesës së informacionit, ndërgjegjësimit të ulët, nivelit të ulët ekonomike dhe varësisë ekonomike, mungesës së besimit tek institucionet.

Në Bashkinë Has, është ndërtuar sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.

Për vitin 2023, evidentohen 10 raste të dhunës në familje, 22 viktima nga të cilat 8 janë gra dhe 14 janë fëmijë. 5 nga viktimat e dhunës rezultojnë të papuna.

Në Bashkinë Has mungojnë shërbime shoqërore në mbështetje të viktimave të dhunës. Mungesa e shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe mungesa e burimeve financiare të Bashkisë për ngritjen e qendrës për menaxhimin e rasteve të dhunës, mungesa e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të specializuara në territor për rasteve të dhunës ka bërë që deri në shtator 2023 rastet e dhunës në bashki të menaxhohen nga stafi i Bashkisë të ndihmuar me familjarë të viktimave të dhunës. Në disa raste bashkia është mbështetur nga OJF që operojnë në Kukës. Ajo që vlen të përmendet është fakti se numri i rasteve të dhunës që trajtohen nga organizatat ka qenë relativisht shumë i ulët, kryesisht vetëm për rastet e rënda.

Megjithëse zhvillimet e mësipërme dhe angazhimet e pushtetit lokal në mbrojtje të viktimave të dhunës, megjithëse janë organizuar fushata të ndryshme informimi dhe ndërgjegjësimi për dhunën në familje, denoncimin e saj, dhe përfitimet e NE, sfidat për Bashkinë Has për mbështetjen e viktimave të dhunës janë:

1. Planifikimi i fondeve lokale për plotësimin e nevojave për menaxhimin e rasteve të dhunës;
2. Rritja e kapaciteteve të stafit të Bashkisë për evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës;
3. Zgjerimi i MKR me kryepelqë të fshatrave;
4. Vijimi i fushatave ndërgjegjësuere për komunitetin, kryesisht në zonat rurale.

Individë/familje në nevojë për strehim social

Bashkia Has, nëpërmjet programeve të strehimit, mbështet grupet më të pafavorizuara. Bashkia nuk ofron shtëpi sociale apo kredi të buta për strehim, por ka një shërbim të veçantë, bonusin mujor për qiranë, e cila u jepet familjeve të përcaktuara dhe përballohet nga fondet e bashkisë.

Bashkia, megjithatë, nuk ka informacion të detajuar për numrin e familjeve që aplikojnë për këtë bonus. Në vitin 2023 numri i familjeve aplikuese për bonus strehimi është dyfishuar në krahasim me numrin e familjeve aplikuese në 2020. Në vitin 2023, numri i familjeve të cilat përfituan nga bonusi i qerasë ka shënuar një rritje, duke trajtuar 95 familje, krahasuar me

89familjet përfituese në vitin 2021. Fondi i bashkisë për këtë bonus ka pësuar rritje gjithashtu, duke arritur në 7.600.000 lekë në vitin 2023, krahasuar me 5.952.000 lekë të përdorura në vitin 2021. (Aneksi 1, Tabela 14)

Sfida më e rëndësishme në lidhje me strehimin në Bashkinë Has:

- Zhvillimi i mekanizmave inovativë që do të adresojnë nevojat e grupeve të pafavorizuara dhe grupeve më të prekura nga mungesa e strehimit. Kjo sfidë ka për qëllim të përfshijë një qasje të re dhe më efikase në trajtimin e çështjeve të strehimit, duke siguruar jo vetëm strehimin e menjëhershëm por edhe përkrahjen e nevojave afatgjata të komunitetit.

Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi

Numri i të moshuarve në Bashkinë Has përbën 10.58% të popullsisë, duke arritur në një total prej 2308 personave. Në këtë numër, 782 të moshuar kërkojnë shërbim shoqëror, prej të cilëve 399 janë gra. Megjithatë, në Bashkinë Has nuk ka asnjë kërkesë për shërbim rezidencial dhe nuk rezultojnë të moshuar të braktisur. Në aspektin e kërkesave, 387 të moshuar kërkojnë shërbim në familje, 187 prej tyre janë gra, ndërsa 395 të moshuar kërkojnë shërbim në qendra ditore, nga të cilët 50% janë gra. Gjithashtu, nga regjistri elektronik kombëtar i NE-se, 14 të moshuar jetojnë vetëm dhe përfitojnë Ndihmën Ekonomike (6 prej tyre janë gra), 13 të moshuar janë të vetmuar (5 prej tyre janë gra), dhe 62 të moshuar janë të sëmurë, nga të cilët 50% janë gra¹².

Bashkia Has aktualisht nuk ofron asnjë shërbim shoqëror për të moshuarit, dhe mungesa e një specialisti të specializuar për çështjet e moshës së tretë bën që trajtimi i nevojave dhe problematikave të këtij grupi të realizohet nga Sektori i Mirëqenies Sociale. Mungesa e Njësive të Nivelit të Parë për të Moshuarit (NJVRN) ka sjellë mungesën e një baze të dhënave të detajuara për numrin e të moshuarve në nevojë, nevojat dhe kërkesat e tyre, si dhe për karakteristikat e tyre, duke patur parasysh edhe gjininë. Kjo mungesë e informacionit detajuar ka vështirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve specifike për të moshuarit në nevojë në Bashkinë Has.¹³

Sfidat e Bashkisë Has për moshën e tretë:

1. Bashkia Has ka potencial për të krijuar programe të reja dhe inovative që plotësojnë nevojat specifike të të moshuarve dhe ofrojnë mbështetje të qëndrueshme për një periudhë të gjatë kohore.
2. Riorganizimin e sektorit Sektori i Mirëqenies Sociale nëpërmjet emërimit të specialistit për moshën e tretë mund të përmirësojë kapacitetin e Bashkisë Has për të identifikuar më mirë nevojat dhe për të ofruar shërbime personalizuar për të moshuarit në nevojë.
3. Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel lokal për rritjen e kujdesit për moshën e tretë;

¹² Tabela 15 Aneksë

¹³ Për nevojat e analizës së situatës së Planit Vendor Social, Bashkia Has ngriti një grup pune Ad-hoc i cili evidentoi nevojat e të moshuarve

4. Planifikimi i fondeve lokale për shërbimet ditore për të moshuarit në nivel njësie administrative mund të bazohet në informacione të strukturuar dhe të detajuara për këtë grup moshe, duke organizuar të dhënat në mënyrë që të ndihmojë në ofrimin më efektiv të shërbimeve dhe në koordinimin e ndihmës së nevojshme për ta
5. Bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm për rritjen e fondeve për shërbime shoqërore për moshën e tretë.

Individë që kanë varësi nga alkooli

Sipas Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Mirëqenies Sociale të Bashkisë Has, nuk ka të dhëna dhe nuk evidentohen individët që kanë varësi nga alkooli. Nuk ka raste të referuara nga njësitë administrative për personat që kanë varësi nga alkooli. Mungojnë të dhënat e detajuara për grupmoshat dhe gjininë e personave që kanë varësi nga alkooli. Këto të dhëna mund të sigurohen duke bashkëpunuar me Komisaritet e Policisë, Zyra Arsimore (shkollat) dhe Strukturat e Shëndetësisë (mjekët e familjes), por mungesa e një protokollit apo mekanizmit ka çuar në një mungesë totale të bashkëpunimit midis institucioneve. Nga ana tjetër mungesa e NJVRN për identifikimin dhe mbështetjen e individëve që kanë varësi nga alkooli ka çuar në mungesën e të dhënave dhe evidentimin e nevojave të individëve që kanë varësi nga alkooli.

Sfidat e Bashkisë Has për këtë grup në nevojë janë:

1. Grumbullimi i të dhënave dhe evidentimi i nevojave të individëve që kanë varësi nga alkooli nëpërmjet ngritjes së NJVRN;
2. Akses në shërbime të individëve që kanë varësi nga alkooli.

Individë që kanë varësi nga droga

Sipas Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Mirëqenies Sociale të Bashkisë Has, nuk ka të dhëna dhe nuk evidentohen individët që kanë varësi nga droga. Nuk ka raste të referuara nga njësitë administrative për personat që kanë varësi nga droga. Mungojnë të dhënat e detajuara për grupmoshat dhe gjininë e personave që kanë varësi nga droga. Këto të dhëna mund të sigurohen duke bashkëpunuar me Komisaritet e Policisë, Zyra Arsimore (shkollat) dhe Strukturat e shëndetësisë (mjekët e familjes), por mungesa e një protokollit apo mekanizmit ka çuar në një mungesë totale të bashkëpunimit midis institucioneve. Nga ana tjetër mungesa e NJVRN për identifikimin dhe mbështetjen e individëve që kanë varësi nga droga ka çuar në mungesën e të dhënave dhe evidentimin e nevojave për këtë kategori.

Sfidat e Bashkisë Has për këtë grup në nevojë janë:

1. Grumbullimi i të dhënave dhe evidentimi i nevojave të individëve që kanë varësi nga droganëpërmjet ngritjes së NJVRN;
2. Akses në shërbime të individëve që kanë varësi nga droga.

Persona LGBTIQ+

Sipas Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Mirëqenies Sociale të Bashkisë Has, nuk ka të dhëna dhe nuk evidentohen individët LGBTIQ+. Nuk ka raste të referuara nga njësitë administrative për këtë kategori. Pra, mungojnë të dhënat e detajuara për grupmoshat dhe nevojat që kanë personat LGBTIQ+. Përveç mungesës së NJVRN mungon një mekanizëm për identifikimin dhe mbështetjen e individëve LGBTIQ+. Këto të dhëna mund të sigurohen duke bashkëpunuar me Komisaritet e Policisë dhe Strukturat e Shëndetësisë, por mungesa e një protokollit apo mekanizmit ka çuar në një mungesë totale të bashkëpunimit midis institucioneve.

Sfidat e Bashkisë Has për këtë grup në nevojë janë:

1. Grumbullimi i të dhënave dhe evidentimi i nevojave të individëve LGBTIQ+ nëpërmjet ngritjes së NJVRN;
2. Akses në shërbime të individëve LGBTIQ+.

Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve

Shërbimet shoqërore të ofruara në vite në Bashkinë Has kanë qenë sporadike, jo të konsoliduara dhe me kapacitete të limituar. Për shërbimet e mëparshme nuk janë realizuar vlerësime apo auditime. Në përfundim të projekteve, për shkak të mungesës së financimit, shërbimet janë mbyllur.

Në bashkinë Has gjatë vitit 2023 nuk ofrohen shërbime shoqërore për grupet në nevojë¹⁴. Megjithatë nga bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është arritur që të krijohet dhe të funksionojë qendra lëvizëse për PAK e cila ofron shërbimet e logopedisë dhe fizioterapsë.

Nga analiza e mësipërme rezulton se nevojat e Bashkisë Has lidhen me:

- A. Ndërtimin e një databaze ku të grumbullohen të dhënat dhe evidentohen nevojave e individëve/ familjeve në nevojë dhe grupeve vulnerabël;
- B. Ngritjen e shërbimeve të shportës së shërbimeve për kategoritë:
 - Fëmijë në nevojë (qendra komunitare);
 - Të rinj (qendër komunitare rinore);
 - Të moshuar (qendër komunitare për të moshuar);
 - Qendra multidisiplinare në njësitë administrative;
 - Qendra shërbimi lëvizëse për familjen dhe fëmijët

Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta brenda organizatës

Analiza e burimeve njerëzore

Bazuar në strukturën e Organikës së Bashkisë Has dhe Rregulloren e saj, Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore është një pjesë kritike e departamentit të shërbimeve të Bashkisë, nën përgjegjësinë e një shefi sektori dhe tre specialistëve. Kjo strukturë administrativo-organizative ka lidhje dhe varësi nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanset e Barabarta¹⁵ nëpërmjet Inspektoratit Rajona¹⁶ për çështje teknike, ligjore dhe trajnime.

Shefi i Sektorit ka një sërë detyrash kyçe që kontribuojnë në funksionimin e qëllimshëm dhe ligjor të sektorit të tij. Në këtë drejtim, detyrat e tij përfshijnë:

- ✓ **Zbatimin ligjshmeri dhe monitorimin normativ:** Është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe për mbikqyrjen e rregullave dhe bazës normative në fushën e tij, duke siguruar përditësime dhe monitorime të rregullave që ndryshojnë ose shtohen në kohë.

¹⁴ Tabela 16 Anekse

¹⁵ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

¹⁶ Citim I rregullores së Bashkisë Has

- ✓ **Organizimin dhe kontrollin e punës së sektorit:** Koordinon dhe monitoron punën e sektorit, duke ndarë përgjegjësitë në baza territoriale dhe në përputhje me numrin e banorëve në secilën zonë.
- ✓ **Rritjen e përvojës së punonjësve:** Kujdeset për organizimin e aktiviteteve që i ndihmojnë punonjësve të sektorit të përfitojnë më shumë përvojë në fushën sociale.
- ✓ **Raportim dhe bashkëpunim efektiv:** Raporton dhe bashkëpunon me kryetarin dhe këshillin bashkiak lidhur me aktivitetet e sektorit, si dhe konsulton dhe bashkëpunon me Drejtorinë Rajonale të SHSSH.
- ✓ **Trajtimin e ankesave të qytetarëve:** Është përgjegjës për adresimin e ankesave të qytetarëve në rastet kur ato nuk janë brenda kompetencës së inspektorëve apo kur ato nuk janë zgjidhur në mënyrë të përshtatshme.
- ✓ **Bashkëpunimi për fondin e ndihmës:** Koordinon dhe bashkëpunon me Ministrinë për të siguruar nevojat dhe argumentet për rritjen e fondit të ndihmës, duke i paraqitur ato në mënyrë të përshtatshme.
- ✓ **Bashkëpunim efektiv me bashkinë dhe sektorët e tjerë:** Bashkëpunon me sektorët e tjerë të bashkisë për të marrë informacionin e nevojshëm për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.
- ✓ **Mbrojtja dhe argumentimi i projekteve para këshillit bashkiak:** Argumenton dhe mbrojt para Këshillit Bashkiak projektet që kanë të bëjnë me ndihmën sociale, siguruar mbështetje për vendimet që marrin.
- ✓ **Përgatitja e evidencave dhe informacionit për autoritetet mbi veprimtarinë:** Përgatit dhe dorëzon dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm në kohën e duhur për inspektoratin rajonal dhe ministrinë, në lidhje me veprimtarinë e sektorit të tij.

Specialisti i Ndhimes Ekonomike dhe aftësisë së kufizuarka përgjegjësi të rëndësishme në sigurimin e procesit të trajtimit të aplikimeve dhe dokumentacionit për ndihmën ekonomike. Detyrat e tij përfshijnë:

- ✓ **Monitorim dhe verifikim:** Monitoron dhe verifikon dokumentacionin e aplikuesve për ndihmë ekonomike, duke siguruar që të gjitha dokumentet përputhen me kriteret e nevojshme ligjore dhe ato të gjendjes ekonomike të aplikuesve.
- ✓ **Zëvendësim i shefit të sektorit:** Zëvendëson shefin e sektorit në raste të pavlefshmërisë së tij për një kohë të shkurtër në lidhje me çështjet e zonës së tij të përgjegjësisë.
- ✓ **Trajtim dokumentacioni dhe verifikim real:** Mbledh dhe verifikon dokumentacionin e aplikanteve, duke siguruar që ky dokumentacion të jetë i plotë dhe i saktë në përputhje me kriteret ligjore, përfshirë edhe verifikimin e gjendjes reale ekonomike të aplikuesve.
- ✓ **Përgjigjet për evidencat e përfituesve të rinj:** Harton dhe paraqet evidencat për përfituesit e rinj, duke përgatitur raporte për vendimet e projektruara në lidhje me këta aplikues.
- ✓ **Përgatitja e listave të pagesave të përfituesve:** Përgatit listat e pagesave përfituesve në zonën e tij, duke përfshirë informacionin e tyre personal për transparencë dhe monitorim të drejtë.
- ✓ **Propozim dhe veprim në rast të paligjshmërisë:** Propozon veprime për heqjen e personave të paligjshëm nga skemat ekonomike, duke u konsultuar me shefin e sektorit dhe juristin për procedurat e duhura ligjore.

- ✓ **Ruajtja dhe trajtimit e dosjeve:** Mban dhe trajton dosjet e perfituesve në përputhje me rregulloret dhe ligjet e arkivimit, siguruar që dokumentacioni të ruhet në mënyrë të rregullt dhe të përputhet me standartet ligjore për arkivimin.

Detyrat e cituara në rregullore nuk përputhen plotësisht kërkesat e legjislacionit për NE, PAK dhe Shërbimet Shoqërore për secilin nga pozicionet e mësipërme¹⁷.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të stafit të Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike është i paplotë dhe jo i organizuar në funksion të grupeve në nevojë. Sipas rregullores specialisti mbulon pjesërisht vetëm detyrat e ngarkuara nga ligji për NE. Në përshkrimin e detyrave të specialistit nuk janë përfshirë detyrat ligjore për specialistin për Aftësinë e Kufizuar dhe Shërbimet Shoqërore për grupet në nevojë. Në rregullore mungojnë pozicionet e Njësisë për Mbrotjen e Fëmijës (NJMF), Punonjësi për Mbrotjen e Fëmijës (PMF) dhe Koordinatorin vendor gjinor. Rolin e NJMF/PMF për të gjithë Bashkinë (4 njësitë administrative) e mbulon përgjegjësi i sektorit.¹⁸ Ngritja e njësisë të vlerësimit të nevojave (NVNR) është detyrim që rrjedh nga Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj, në nenin 36 (pikat 2, 3 dhe 4) ka specifikuar qartësisht detyrimin e Bashkive për të ngritur struktura që përmbushin role dhe funksione specifike në këndvështrimin e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin vendor.

Të gjitha këto kanë bërë që bashkia të mos evidentojë kategoritë në nevojë dhe kërkesat e tyre, të mos ketë sistem aktiv të të dhënave (një data bazë me të dhënat) për individët dhe familjet në vështirësi si dhe nevojat e tyre për mbështetje. E gjitha kjo prezantoi vështirësi në grumbullimin e të dhënave për hartimin e planit social.

Analiza PESTLE ¹⁹

Faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknikë, ligjorë dhe mjedisorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të Bashkisë Has janë si më poshtë:

Faktori politik: Bashkia Has përdor legjislacionin vendas për të ndërtuar programe mbështetëse për grupet e vulnerable. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse, institucionet publike dhe sektorin privat lejon krijimin e partneriteteve të ndryshme, rritjen e efikasitetit dhe përmbushjen e nevojave të komunitetit.

Faktorët ekonomikë: Bashkia punon në mënyrë të ngushtë me aktorët lokalë për menaxhimin efikas të burimeve financiare. Përkundër ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe nivelit të lartë të papunësisë, bashkia po bën përpjeke për të siguruar shërbime sociale cilësore për të përmbushur nevojat e komunitetit.

Faktorët socialë: Bashkia Has reflekton një realitet me sfida sociale të rëndësishme, ku rritja e popullsisë mbi 65 vjeç dhe ulja e popullsisë 0-18 vjeç, së bashku me numrin e rritur të familjeve në nevojë dhe individëve me aftësi të kufizuara, paraqesin një kontekst me nevoja të thella. Së bashku me këtë, trendi i zvogëlimit të të rinjve që vazhdojnë arsimin e mesëm dhe oferta e kufizuar për punësim dhe formim profesional, reflektojnë nevojën për përmirësim në këto fusha. Në anën tjetër, trashëgimia kulturore e pasur e Bashkisë Has ofron

¹⁷ Aktualisht Bashkia Has është në fazën e rishikimit të rregullores së saj.

¹⁸ Këto funksione nuk janë në përshkrimin e punës së përgjegjës të sektorit sipas rregullores së institucionit

¹⁹ PESTLE është një akronim për faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknikë, ligjorë dhe mjedisorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të bashkisë.

potencial për zhvillim kulturor dhe turistik, ndërsa shërbimet sociale po ideoen t'u përgjigjur drejtpërdrejt nevojave të komunitetit. Megjithatë, përdorimi i kufizuar i teknologjisë tek grupmoshat e reja shfaq nevojën për një përdorim më të gjerë dhe më efikas të teknologjisë për të përmbushur më mirë nevojat sociale.

Faktorët teknikë: Regjistrat Elektronik Kombëtarë për NE, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet sociale kanë përmirësuar aksesin dhe bashkëpunimin mes institucioneve. Administrata e bashkisë, e aftë në përdorimin e këtyre regjistrave ka ndihmuar për lehtësimin e procesit të aksesit të individëve në nevojë për shërbime sociale.

Faktori ligjorë: Bashkia Has ndërton veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin, duke siguruar që ofrimi i shërbimeve sociale të përputhet me standardet dhe rregulloret vendore dhe kombëtare.

Faktorët mjedisorë: Pozita gjeografike dhe potenciali natyror i bashkisë (bimët mjekësore, turizmi) janë elemente pozitive që mund të ndikojnë në rritjen e shërbimeve sociale. Megjithatë, sfidat si emigrimi, plakja e popullsisë dhe mungesa e shoqërisë civile kërkojnë strategji të veçanta për të adresuar nevojat sociale në këto kushte.

Në përgjithësi, ndryshimet dhe përpjekjet që po bëhen në nivel lokal për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale tregojnë për një angazhim pozitiv dhe një vizion për rritjen e cilësisë së jetës së komunitetit në Bashkinë Has. Bashkia po përdor plane dhe programe për të maksimizuar përparësitë dhe rritur cilësinë e shërbimeve sociale duke marrë parasysh faktorët mjedisore dhe kushtet e rrethit.

Analiza SËOT

Pikat e forta

- Kërkesa emergjente për shërbime sociale ka rritur nevojën për veprim në Bashkinë Has, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për përmirësimin e ofertës së tyre për shërbime sociale në mungesë.
- Objektivi politik i Bashkisë për sigurimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë shpreh një përkushtim të theksuar për përmirësimin e kushteve sociale për grupet më të prekura, dëshmuar qartë nga kryesia, tregues i një vullneti të fuqishëm për ndryshim dhe avancim.
- Bashkia Has dallon për kapacitetet e përshtatshme njerëzore dhe teknike për të zhvilluar dhe menaxhuar shërbime cilësore sociale, duke dëshmuar potencial dhe hapësira të dukshme për rritje në këtë sektor.
- Bashkia ka treguar një histori të përkushtimit të vazhdueshëm në përmirësimin e kushteve sociale për grupet vulnerable, duke dëshmuar një angazhim të qëndrueshëm dhe një histori të suksesshme në këtë fushë.
- Potenciali për zhvillim dhe rritje në Bashkinë disponon hapësira dhe mundësi për ndërtimin e shërbimeve sociale në të ardhmen.
- Kapaciteti i Bashkisë për të thithur fonde dhe zgjerimi i burimeve financiare tregojnë pavarësi vendimmarrëse, duke mundësuar vendime efikase dhe strategji të pavarura për avancimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale.

Pika të dobëta

- Mungesa e informacionit për grupet vulnerabile dhe nevojat e tyre specifike për shërbime sociale kufizon kapacitetin për përgatitjen dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme për këto grupe të nevojshme.
- Mungesa e mbështetjes financiare për shërbimet sociale është një sfidë për Bashkinë Has, pasi burimet e saj të veta të financimit janë të kufizuara, gjë që bën që furnizimi i tyre në nivelin e duhur të jetë i vështirësuar.
- Mungesa e një Fondi Social të dedikuar për nevojat e grupeve vulnerabile prezanton mangësinë e financimeve për shërbimet sociale, duke e bërë këtë proces më të vështirë për t'u mbuluar.
- Mungesa e partneriteteve me organizata ndërkombëtare kufizon ndihmën dhe burimet potenciale për zgjerimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.
- Prezenca e ulët e organizatave jo-fitimprurëse në territorin e Bashkisë zvogëlon disponueshmërinë e shërbimeve për komunitetin.
- Mungesa e ekspertizës lokale në fushën e ofrimit, administrimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale kufizon efikasitetin dhe përmirësimin e tyre në nivel lokal, duke ndikuar në cilësinë dhe zbatimin e tyre të suksesshëm.

Mundësitë

- Potenciali për zhvillim dhe financim të shërbimeve sociale në Bashkinë Has shërben si rrugëdrejtës për zgjerimin e ofrimit të tyre për grupet në nevojë dhe për rritjen e mbulimit të tyre, duke paraqitur një mundësi konkrete për avancim në këtë fushë.
- Përmirësimi i qeverisjes qendrore dhe proceseve reformatore përbën një mundësi për të optimizuar ofrimin e shërbimeve sociale dhe përmirësimin e cilësisë së tyre.
- Decentralizimi i shërbimeve sociale i ofron Bashkisë mundësinë për të ofruar shërbime më të përshtatshme, pranë dhe në bazë të nevojave të komunitetit.
- Bashkia Has bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me donatorë vendas dhe ndërkombëtarë për sigurimin e fondeve për projektet sociale, të përcaktuara sipas prioriteteve të Planit Vendor Social.
- Bashkëpunimi me biznese që operojnë në territorin e Bashkisë mund të paraqesë një burim potencial për të ndihmuar në rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e shërbimeve sociale të Bashkisë.
- Legjislacioni kombëtar dhe strategjitë kombëtare ofrojnë orientim dhe shërbejnë si udhërrëfyes për Bashkinë në ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve sociale.
- Bashkia Has asistohet nga ndihma e donatorëve ndërkombëtarë për të rritur kapacitetet e stafit, duke përmirësuar aftësitë e tyre për të identifikuar dhe ofruar shërbime sociale në mënyrë më efikase.

Rreziqet

- Niveli i lartë i emigracionit dhe migracionit mund të sjellë ndryshime të papritura në strukturën dhe nevojat e komunitetit lokal, rritur kështu sfidat për Bashkinë e Hasit për t'u përpyetur me sukses për t'i përmbushur kërkesat emergjente të krijuara.
- Mungesa e koordinimit mes sektorëve dhe institucioneve rrezikon të pengojë ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë të përshtatshme dhe efikase në Bashkinë Has.

- Mungesa e interesit të organizatave jo-fitimprurëse mund të kufizojë gamën dhe mbështetjen e shërbimeve sociale në dispozicion në Bashkinë Has, ndërsa mungesa e shoqërisë civile mund të kufizojë mundësitë e Bashkisë për të zhvilluar shërbime të reja dhe inovative, rritur kështu varësinë e saj nga burimet publike.
- Mungesa e përfshirjes së institucioneve lokale mund të kenë ndikim negativ në cilësinë dhe funksionimin e shërbimeve sociale.
- Mungesa e përvojës dhe traditës mund të krijojë pengesa në lidhjen e partneriteteve me organizma vendas dhe ndërkombëtare për zhvillimin dhe menaxhimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Has.

III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Plani Social Vendor në Bashkinë Has synon të sigurojë një gamë të gjerë shërbimesh për grupet në nevojë duke përfshirë një strategji të bashkëpunimit midis sektorëve në Bashki, me institucionet lokale dhe rajonale, organizatat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bizneset lokale për të përmirësuar shërbimet sociale. Përmes planifikimit dhe implementimit të veprimeve të përshtatshme, synohet të reduktohet dhe të lehtësohet varfëria në Bashkinë Has, duke përmirësuar shërbimet për familjet, fëmijët dhe individët në nevojë, të përfshirë në varfëri ekstreme. Synimi është të krijohet një ambient më i mirë për personat me aftësi të kufizuara, duke integruar sistemin e pagesave në shërbimet e shoqërore të ofruara. Kjo synon të inkurajojë integrimin e tyre në shoqëri dhe ekonomi. Bashkia synon të sigurohen shërbime të kujdesit shoqëror me standarde për të gjitha grupet në nevojë në territorin e Bashkisë Has përmes fuqizimit, riorganizimit dhe koordinimit të shërbimeve sociale.

Qëllimi i Planit Social Vendor, Bashkia Has është përmirësimi i cilësisë së jetës së të gjithë banorëve duke siguruar qasje të barabarta në shërbimet të integruara sociale, ndërtuar një ambient mjedisor të qëndrueshëm dhe inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe vendimeve që kanë ndikim në të gjithë komunitetin.

Për të arritur këtë qëllim, synohet ngritja, fuqizimi, riorganizimi dhe koordinimi i shërbimeve shoqërore, duke siguruar një qasje holistike dhe efikase për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe të ofrimit të ndihmës në nivel vendor/komunitar.

Objektivat specifikë për arritjen e qëllimit të planit social vendor janë:

Objektivi specifik 1“Përmirësimi i performancës së stafit të Bashkisë Has në fushën e shërbimeve sociale përmes identifikimit të nevojave për trajnime të specializuara dhe rishikimit të strukturës së sektorit të dhe mbrotjes sociale dhe ndihmës ekonomike për të siguruar një efikasitet dhe koordinim më të mirë të burimeve njerëzore.”

Masat për realizimin e objektivit janë:

Masa 1 Riorganizimi i Sektorit tëNdihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqëroredhe rritja e kapaciteteve të administratorëve socialë.

Masa 2 Ngritja dhe organizimi i Sektorit Mbrojtjes Sociale duke përfshirë Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave.

Masa 3 Ngritja dhe funksionimi i Njësisë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe rritja e kapaciteteve të stafit të NJVNR.

Objektivi specifik 2 “Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale në Bashkinë Has duke ndërthurur pagesat në cash me shërbime shoqërore për të siguruar një qasje të përmirësuar dhe më efikase të ndihmës së ofruar për familjen dhe individin në nevojë.”

Masat për realizimin e objektivit janë:

Masa 1. Rritja e efikasitetit të skemave të Ndihmës Ekonomike nëpërmjet shënjestrimit të familjeve ekstremisht të varfra:

- ✓ Rritja e efikasitetit të skemave të Ndihmës Ekonomike nëpërmjet shënjestrimit të familjeve ekstremisht të varfra
- ✓ Fuqizimi ekonomik i grupeve të disavatazuara nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE.
- ✓ Mbështetje të individëve dhe familjeve vulnerabel nga skemat të tjera mbështetëse të ofruara nga bashkia

Masa 2 Rritja e efikasitetit të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara

- ✓ Rritja e efikasitetit të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara me pagesën e AK
- ✓ Fuqizimi ekonomik i PAK
- ✓ Personat me AK dhe familjeve të tyre përfitojnë shërbime nga skema të tjera mbështetëse nga Bashkia Has

Masa 3 Ndërtimi i shportës së shërbimeve sociale duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për familjet, dhe individët në nevojë, veçanërisht për fëmijët, të rinjtë, viktimat e dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

- ✓ Ngritja e shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë
- ✓ Ngritja e shërbimeve për PAK
- ✓ Ngritja e shërbimeve për familjen dhe personat e moshuar
- ✓ Ngritja e sistemit të mbështetjes së viktimave të dhunës dhe trafikimit
- ✓ Ngritja e shërbimeve multifunksionale në nivel njësie administrative
- ✓ Ngritja e shërbimeve lëvizëse për AK

Objektivi specifik 3 “Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit në Bashkinë Has përmes organizimit të fushatave të informimit, takimeve të hapura dhe platformave të konsultimeve për të inkurajuar qytetarët të marrin pjesë aktivisht në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale”.

Masat për realizimin e objektivit janë:

Masa 1 Fushata Informative dhe Edukative:

- ✓ Organizimi i fushatave të informimit nëpërmjet mediave sociale,
- ✓ Takimeve të hapura,

- ✓ Punëtori për të sensibilizuar komunitetin lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin vendimmarrës.

Masa 2 Krijimi i Platformave të Konsultimeve Publike:

- ✓ Implementimi i platformave të përbashkëta në rrjetet sociale ose sesioneve të hapura për diskutime dhe konsultime, duke i dhënë qytetarëve mundësinë të japin kontributin e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe projekteve sociale.

Masa 3 Iniciativa për Pjesëmarrje Aktive:

- ✓ Inkurajimi i krijimit të grupeve të punës të përbashkëta mes autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të komunitetit për të konsideruar nevojat dhe propozimet e qytetarëve në hartimin e politikave të reja sociale.

IV. PLANI I VEPRIMIT

MATRICA E PLANIT VENDOR SOCIAL BASHKIA HAS

Qëllimi i Planit Social Vendor, Bashkia Has, është përmirësimi i cilësisë së jetës së të gjithë banorëve duke siguruar qasje të barabarta në shërbimet të integruara sociale, ndërtuar një ambient mjedisor të qëndrueshëm dhe inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe vendimeve që kanë ndikim në të gjithë komunitetin

Objektivi Specifik 1 “Përmirësimi i performancës së stafit të Bashkisë Has në fushën e shërbimeve sociale përmes identifikimit të nevojave për trajnime të specializuara dhe rishikimit të strukturës së sektorit të dhe mbrotjes sociale dhe ndihmës ekonomike për të siguruar një efikasitet dhe koordinim më të mirë të burimeve njerëzore”

Objektivat	Indikatori	Afati i zbatimit		Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
		Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/ sektori/ departamenti (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)
Objektivi Specifik 1: Përmirësimi i performancës së stafit të Bashkisë Has në fushën e shërbimeve sociale përmes identifikimit të nevojave për trajnime të specializuara dhe rishikimit të strukturës së sektorit të dhe mbrotjes sociale dhe ndihmës ekonomike për të siguruar një efikasitet dhe koordinim më të mirë të burimeve njerëzore”						
<i>1.1 Vlerësimi i ngarkesës së punës për NE dhe PAK të administratorëve shoqërorë në Bashkinë HAS (për qytetin dhe njësitë administrative)</i>		i) 1 (një) Matricë e vleresimit te punes se hartuar ii) Grumbullimi periodik i matricave iii) Një Raport i hartuar mbi matricat	2024	2024	Bashkia 35,628.00 Leke	i) Sektori I Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore ii) Departamenti i Burimeve Njerezore

<p>1.2 Rishikimi i përshkrimit të punës së administratorëve shoqërorë (për qytetin dhe njësitë administrative) dhe përfshirja e tyre në Rregulloren e Bashkisë Has</p>		<p>Çdo adminsitrator shoqëror ka një përshkrim pune të detajuar</p>		<p>2024</p>	<p>35,628.00 Leke/Bashkia</p>	<p>i) Sektori I Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore. ii) Departamenti i Burimeve Njerezore</p>	<p>SHSSH</p>
<p>1.3 Riorganizimi i strukturës për zbatimin e NE dhe AK në nivel bashkie</p>		<p>i)Sektori i NE dhe AK i ngritur dhe funksional ii) 1 adminsitrator shoqëror i shtuar për AK në 2025</p>	<p>2024</p>	<p>2026</p>	<p>646,704.00 Lek ne vit/Bashkia</p>	<p>i) Sektori I Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore. ii) Departamenti i Burimeve Njerezore</p>	<p>SHSSH</p>
<p>1.4 Rritja e kapaciteteve të strukturave të Bashkisë, në fusha që përfshijnë administrimin dhe monitorimin e skemës së Ndhmës Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar</p>		<p>i) 3 (tre) trajnime të realizuara ii) 5 [unonjes përmirësojnë performancën në punë</p>	<p>2024</p>	<p>2026</p>	<p>100,000.00 Lek/Donator (I pambuluar)</p>	<p>i) Sektori I Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore ii) Departamenti i Burimeve Njerezore</p>	
<p>2.1 Ngritja e Sektorit të Mbrojtjes Sociale</p>		<p>Sektori i riorganizuar i ngritur dhe funksional : i) 1 Pergjegjes sektori per Sherbimet ii) 1 (nje) Punonjesi gjinor (koordinatori vendor per dhunen) dhe specialist per grupet ne nevoje iii)1 (nje) PMF/NJM dhe specialist per vleresimin dhe referimin e nevojave</p>	<p>2024</p>	<p>2026</p>	<p>894,015.00 lek ne vit /Bashkia</p>	<p>i) Sektori MS ii) Departamenti i Burimeve Njerezore</p>	

2.4 Rritja e kapaciteteve të stafit të Sektorit të Mbrojtjes Sociale		3 trajnime të realizuara 3 persona marrin pjesë në trajnime	2024	2026	180,000.00 Lek nevit/Donator (I pambulluar)	i) Sektori MS ii) Departamenti i Burimeve Njerezore iii) NJVNR në Njësitë Administrative	OJF
TOTAL OS 1					2091975	Leke	

Objektivi specifik 2 “Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale në Bashkinë Has duke ndërthurur pagesat në cash me shërbime shoqërore për të siguruar një qasje të përmirësuar dhe më efektive të ndihmës së ofruar për familjen dhe individin në nevojë.”
Masat për realizimin e objektivit janë”

	Indikator	Afati i zbatimit		Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
Objektivat		Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/sektori i/departamenti (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)
Objektivi specifik 2. Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale në Bashkinë Has duke ndërthurur pagesat në cash me shërbime shoqërore për të siguruar një qasje të përmirësuar dhe më efektive të ndihmës së ofruar për familjen dhe individin në nevojë.” Masat për realizimin e objektivit janë”						

	1.1.1 Vlerësimi i nevojave të familjeve në nevojë përfituese ose jo të NE	Databaze me të dhënat e familjeve në nevojë është ngritur dhe përditësohetperiodikisht	2024	2027	Bashkia 245,760.00 lek/vit	Sektori i NE	
	1.1.2 Mbështetje sa më e plotë e familjeve në nevojë përmjet ofrit të NE	Mbi 99 % e familjeve aplikuese te NE, vlersohen përfituese të NE-së	2024	2027	234,000,000 lek /vit MSHMS	Sektori i NE	SHSSH
	1.1.3. Mbështetje e familjeve të varfëra nëpërmjet ofrimit të NE nga fondi 6%	Mbi 177 familje ne vit përfitojnë nga skema e NE me fondin 6%	2024	2027	11,950,126 lek/vit MSHMS	Sektori i NE	SHSH
	1.2.1. Evidentimi, gjurmimi, dhe largimi nga skema e NE e familjeve abuzive	3% e familjeve të verifikuara largohen nga skema	2024	2027	Bashkia 245,760.00 lek/vit	Sektori i NE	

	1.2.2 Nxitja e integritit të përfituese nga skema e Ndhmës Ekonomike në skemat e punësimit	i) Mbi 80 % e familjeve përfituese të NE mbi 5 vite, nxiten te largohen nga skema e NE npërmjet punësimit	2024	2027	Bashkia 122,880.00 lek/vit	Sektori i NE	Zyra e Punësimit Has
	1.3.1 Nxitjes se iniciativave lokale nëpërmjet mbështetjes së Ndërmarrjeve sociale për përfshirjen e grupeve të disavantazuara ne tregun e punes .	4 fushata ndërgjegjësimi mbi Ndërmarrjet sociale	2024	2027	Bashkia 20,480.00 lek/vit	Sektori i NE	MSHMS/ DRSHSSH & OJF
1.3.2 Pëmirësimi i kushteve të jetësës per familjet dhe individet ne nevojë nëpërmjet shërbimit të Strehimit	i) 100 familjeve përfituese të bonusit të qërase	2024	2027		i) Sektori i NE ii) Drejtoria e strehimit		

	2.1.1 Evidentimi i personave me aftësi të kufizuar dhe vlerësimi i nevojave të tyre	Databaze me të dhënat e personave me aftësi të kufizuar dhe evidentimi i nevojave për ndihmë është ngritur dhe përditësohet periodikisht	2024	2027	Bashkia 153,600.00 lek/vit Bashkia	Spektori i NE	OJF
	2.1.2 Bashkëpunimi me SHSSH /Komisionet e vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Bashkinë Kurbën për mbështetjen dhe asistimin e personave aplikues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar	Rreth 100% persona që aplikojë për përfitim të AK asistohen dhe mbështeten për vlerësimin bio-psiko-social nga KSHVAK	2024	2027	Bashkia 153,600 lek/vit	Spektori i NE	DRSHSSH Kukes dhe OJF
	2.1.3 Mbeshtetja e PAK me pagese mujore në cash për shkak të AK	100% e personave të vlerësuar zyrtarisht si PAK (invalid, Para dhe tetra plegjik, të verber dhe PAK)	2024	2027	113,500,000.00 Lek në vit MSHMS	Spektori i NE	DRSHSSH Kukes dhe OJF
	2.1.4 Standartizimi dhe unifikimi i planit zhvillimor një vjeçar për personat me AK të vlerësuar nga KSHVAF	1 (një) guidë dhe një format i planit zhvillimor 1 vjeçar i unifikuar i realizuar	2024	2027	Bashkia 15,360 Lek Bashkia	Spektori i NE	DRSHSSH Lezhe dhe OJF

	2.1.5. Aftësimi i Admistratorëve Shoqërorë për hartimin e planit zhvillimor 1 vjeçar dhe monitorimin e tij	i) 1 (një) trajnim i realizuar ii) 4 administratorë shoqërorë aftësohen të hartojnë dhe monitorojnë planet zhvillimore 1 vjeçare	2024	2025	80,000.00 Lek/Bashkia	Spektori i NE dhe shërbimeve shoqërore	DRSHSSH Lezhe dhe OJF
	2.1.6 Evidentimi, gjurmimi dhe largimi nga përfitimi i AK i rasteve abuzive	3 % e rasteve abuzive evitohen dhe largohen nga përfitimi i AK	2024	2027	Bashkia 245,760 Lek/vit Bashkia	Spektori i NE	DRSHSSH Has
	2.1.7 Standartizimi, unifikimi dhe plotësimi me të dhëna të tjera të regjistrit të AK që përdorin administratorët shoqërorë, rishikimi periodik I tij	Një regjistër i unifikuar i AK i realizuar		2024	Bashkia 112,880.00 lek/vit Bashkia	Spektori i NE dhe shërbimeve shoqërore	DRSHSSH Kukes

	2.1.8 Institucionalizimi i bashkëpunimit të Bashkisë Has me ofruesit e aktorët lokalë që kanë në fokus Aftësinë e Kufizuar	Marrëveshje të nënshkruara me : ZA Has, DSHP Kurbin, Zyrën e Punësimit Has, inspektoriantin e Punës, Dhomën e Tregtisë Has, OJF		2024	Bashkia 15360 lek Bashkia	i) Sektori i NE dhe ii) Drejtoria Juridike Bashkia Has	ZA Has, DSHP Has, Zyrën e Punësimit Has, Inspektoriantin e Punës, Dhomën e Tregtisë Has, OJF të ndryshme
	2.1.9 Aftësimi i Ndihmësve Personalë për të ofruar shërbime cilësorë për PAK	i) 1 (një) modul i hartuar ii) 4 administratorë shoqërorë aftësohen të trajnojnë Ndihmësat Personalë iii) Çdo ndihmës personal i trajnuar për shërbimin që do të ofrojnë	2024	2027	40,000 lek Donator (I pambulluar)	Sektori i NE	DRSHSSH Kukes dhe OJF
	2.2.1 Këshillimi për aftësimin e PAK për punësim dhe formim profesional	30% e PAK me kufizime të lehta këshillohen rreth aftësive për jetën, punësim dhe formim profesional	2024	2027	Bashkia 112,880.00 lek/vit Bashkia	Sektori i NE	Zyra e Punës dhe OJF

	2.3.1 Evidentimi i PAK që kërkojnë mbështetje për bonus qëraje 2.3.2) x% e buxhetit të bashkisë alokohet për menaxhimin e PAK në nevojë	i) 3 PAK në vit përfitues të bonusit të qerasë	2024	2027		i) Sektori i NE ii) Drejtoria e Strehimit	
	3.1 Evidentimi i personave që kërkojnë mbështetje dhe vlerësimi i nevojave të tyre	Databaza me të dhënat e individëve në nevojë (për çdo kategori) është ngritur dhe përditësohet periodikisht	2024	2027	Bashkia 368,640 lek ne vit/Bashkia	Sektori i Mbrotjes Sociale, (MS), Bashkia Has	OJF
	3.2Rishikimi vjetor i planit social vendor	Plani social vendor rishikohet cdo vit	2024	2027	Bashkia 30,720.00 lek/vit Bashkia	Sektori i MS /NJVRN, Drejtoria Ekonomike ,	OJF

	3.3Paraqitja e një harte të qartë mbi shtrirjen që kanë qendrat që ofrojnë shërbime të kujdesit social dhe gjendjen në të cilën ndodhen këto qendra	i) Hartohet harta e shtrirjes së shërbimeve sociale dhe publikohet në ëeb e bashkisë ii) Rishikimi i vjetor i hartës	2024	2027	Bashkia 38,400.00 lek ne vit Bashkia	Spektori i MS dhe NJVRN,	OJF
	3.4 Shërbime parashoqërore të ofruara për përfituesit nga ofruesit e shërbimeve	100% e përfitueseve të shërbimeve shoqërore përfitojnë shërbim para se të frekuentojnë shërbimet	2024	2026	Bashkia 324,760.00 lek ne vit/Bashkia	Spektori i MS	institucione lokale dhe OJF
	3.4.1 Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve per AK Krume	1 shërbim i ngritur dhe funksional		2024	3000000 ne vit Donator (I pambuluar)	Spektori i MS	

	3.4.2 Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve lëvizëse per AK	1 shërbime lëvizëse të ngritura dhe funksionale	2024	2027	8800000 ne vit Donator (I pambuluar)	Sektori i MS	MSHMS OJF
	3.5.1 Ngritja e qendrave multifunkionale për fëmijët dhe komunitetin	Ngritja e të paktën 3 qendrave multifunkionale për fëmijët dhe komunitetin (1 në cdo NJA)	2024	2027	11,640,000.00 lek ne vit/Donator (I pambuluar)	Sektori I MS	OJF
	3.5.2 Ngritja dhe funksionimi i Qendrës Rinore	Qendra Rinore e ngritur dhe funksionale	2024	2027	Bashkia 2,920,358.00 lek ne vit Donator I pambuluar	Bashkia Has	OJF

3.5.3 Rritja e bashkëpunimit dhe e advokacisë për buxhetim me focus mbrojtjen e fëmijëve	a) fondi nga taksat lokale i alokuar për mbrojtjen e fëmijëve	i)Parashikim i raste të fëmijëve që kërkojnë mbrojtje ii) % e buxhetit të bashkisë alokohet për menaxhimin e fëmijëve në nevojë	2024	2027	Bashkia 204,800 lek ne vit Bashkia 100,000.00 lek ne vit Bashkia	Sektori i MS	OJF
	3.6.1 Evidentimi i problematikës së moshës së tretë dhe hartimi i një databaze të të moshuarve në nevojë	1 (një) Data baze e ndërtuar dhe funksionale rishikohet periodikisht	2024	2027	Bashkia 92,160.00 lek ne vit Bashkia	Sektori i MS	OJF
	3.6.2Shërbimeve komunitare për moshën e tretë	2 shërbime komunitare për moshën e tretë te ngritura (Kafe me gjyshin)	2024	2027	Bashkia 120.000 lek/vit Bashkia	Sektori i MS	OJF

	3.6.3 Shërbime në familje për moshën e tretë	4 shërbime në familje i ofruar për moshën e tretë(1 në cdo NJA)	2024	2027	5,000,000.00 lek Donator I pambuluar	Spektori i MS	OJF
	3.6.4.1 Mbeshtetje e rasteve te dhunes ne situatë emergjence	Bashkia parashikon fonde nga te ardhurat e veta	2024	2027	Bashkia 50,000.00 lek ne vit Bashkia	Spektori I MS dhe sektori I finances	
	3.7.4.1 Sherbime multifunksiionale per familjen dhe grupet ne nevoje	4 Sherbime te ngritura	2024	2027	4,000,000.00 Lek ne vit Donator (I pambuluar)	Spektori I MS	OJF

TOTAL OB 2

43,3836,032

Lekë

Objektivi specifik 3“Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit në Bashkinë Has përmes organizimit të fushatave të informimit, takimeve të hapura dhe platformave të konsultimeve për të inkurajuar qytetarët të marrin pjesë aktivisht në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale”

Objektivat	Indikatori	Afati i zbatimit		Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse		
		Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/sektori/ departamenti (udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)	
Objektivi Specifik . Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit në Bashkinë Has përmes organizimit të fushatave të informimit, takimeve të hapura dhe platformave të konsultimeve për të inkurajuar qytetarët të marrin pjesë aktivisht në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale							
	1.1 Organizimi i fushatave informative dhe Edukative	12 fushata ne cdo Njese Admin ne vit (1aktivitet ne muaj per informimin e komunitetit per NE, PAK, femijet, te rinjte, te moshuarit, viktimat e dhunes dhe trafikimit etj)	2024	2027	Bashkia 122,880.00 lek/vit	i) Drejtoria e NE&MS ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF
	1.2 Takimeve të hapura	4 takime te hapura ne cdo Nj Administrative ne vit	2024	2027	Bashkia 30,720.00 lek/vit	i) Drejtoria NE&MS. ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF

	1.3 Punëtori për të sensibilizuar komunitetin lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin vendimmarrës	3 punetori te organizuara ne vit	2024	2027	Bashkia 30,720.00 lek/vit	i) Drejtoria e .NE&MS. ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF
	2.1 Rritja e bashkepunimit me komunitetin nepermjet Platformave konsultative Publike per ceshjet sociale	Hartimi i platformave konsultative per pjesmarrjen e komunitetit	2024	2027	Bashkia 76,800.00 lek ne vit	i) Drejtoria e .NE&MS dhe Specialisti I komunikimit / Njesite administrative	OJF
	3.1 Inkurajimi i krijimit të grupeve të punës të përbashkëta mes autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të komunitetit	Ngritja e fuqizimi i grupeve te perbashketa ne cdo njesi administrative	2024	2027	Bashkia 800,000 lek Donator I pambuluar	i) Sektori MS ii) Departamenti i Burimeve Njerezore iii) Njësitë Adminsitrative	OJF

TOTAL OS 3	3.2 Organizimi I takimeve periodike	2 takime ne vit per cdo njesi administrative	2024	2027	80,000.00 lek ne vit Bashkia	i) Sektori MS ii) Departamenti i Burimeve Njerezore iii) Njësitë Adminsitrative	OJF
						1381120	Leke

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Planit Social për periudhën 2024-2027 është i organizuar në mënyrë të strukturuar dhe të përpiktë. Korniza e monitorimit dhe vlerësimit përfshin disa elemente kyçe:

- 1) Për çdo aktivitet të planifikuar, është përcaktuar një njësi përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e tij. Për të lehtësuar këtë proces, është hartuar një listë treguesish që do të ndihmojë në vlerësimin e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së çdo aktiviteti.
- 2) Matrica e Veprimit të Planit ka identifikuar financuesit kyç dhe ka qartësuar angazhimin për zgjerimin e partneritetit me organizata, ofrues shërbimesh dhe donatorë.
- 3) Përveç monitorimit të aktiviteteve sipas afateve kohore specifike, Plani do të rishikohet çdo vit. Rishikimi do të përfshijë analizën e ndryshimeve dhe zhvillimeve afatshkurtra lokale, duke reflektuar nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.
- 4) Matrica e Planit ka parashikuar masa konkrete për rishikim, duke përfshirë mbledhjen periodike dhe analizën e treguesve socialë, konsultime dhe dëgjime periodike me partnerë të Bashkisë dhe përfaqësues të përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- 5) Monitorimi dhe vlerësimi i Planit do të realizohet përmes ngritjes së Njësisë për Vlerësim dhe Rishikim të Nevojave (NJVRN) dhe rritjes së kapaciteteve të saj për monitorimin dhe vlerësimin e planit të veprimit. Konkluzionet e këtij procesi do të reflektohen në rishikimin vjetor të Planit Social.
- 6) Për disa aktivitete në Plan që janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare, si Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Inspektorati Shtetëror, Avokati i Popullit dhe Shërbimi Social Shtetëror, rezultatet e këtyre proceseve do të marrin parasysh gjatë vlerësimit dhe rishikimit të planit.

VI. ANEKSI 1 - TABELAT

Tabela 1 Të dhëna demografike

Njësitë administrative	Popullsia e Bashkisë Has viti 2020			Popullsia e Bashkisë Has viti 2023		
	Total	M	F	Total	M	F
Njësia administrative Krumë	8,040	4130	3,910	7998	4,032	3,966
Njësia administrative Golaj	8,135	4179	3,956	8125	4,102	4,023
Njësia administrative Fajza	4,360	2240	2,120	4,352	2,197	2,155
Njësia administrative Gjinaj	1,360	699	661	1,325	669	656
Total	21895	11247	10,648	21,800	11,000	10,800

Tabela 2 Të dhëna demografike sipas grupmoshës

Grupmosha	Popullsia sipas grupmoshave 2020					Popullsia sipas grupmoshave 2023				
	NJA Krumë	NJA Golaj	NJA Fajza	NJA Gjinaj	Total	NJA Krumë	NJA Golaj	NJA Fajza	NJA Gjinaj	Total
0-4	404	408	219	68	1,099	382	388	208	63	1,042
5-9	458	464	249	78	1,248	444	451	242	74	1,211
10-14	459	465	249	78	1,250	457	464	249	76	1,246
15-19	532	539	289	90	1,449	498	506	271	83	1,358
20-24	604	611	327	102	1,644	568	577	309	94	1,549
25-29	663	671	360	112	1,806	636	646	346	105	1,733
30-34	597	604	324	101	1,625	608	618	331	101	1,657
35-39	508	514	276	86	1,384	524	533	285	87	1,429
40-44	457	462	248	77	1,244	462	470	252	77	1,260
45-49	477	482	259	81	1,298	470	477	256	78	1,280
50-54	531	538	288	90	1,447	515	523	280	85	1,403
55-59	561	568	304	95	1,528	552	561	300	91	1,505

60-64	545	552	296	92	1,484	565	574	307	94	1,540
65-69	434	439	235	73	1,182	470	477	255	78	1,280
70-74	326	329	177	55	887	342	348	186	57	933
75-79	240	242	130	41	652	242	246	132	40	660
80-84	170	172	92	29	464	183	185	99	30	498
85+	75	76	41	13	204	80	81	43	13	217
Total	8,040	8,135	4,360	1,360	21,897	7,998	8,125	4,352	1,325	21,800

Tabela 3. Ecuria e skemës së NE në vite për çdo Njësi Administrative

Njësitë Administrative	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Njësia Administrative Krume	524	534	533	570
Njësia Administrative Golaj	602	629	629	622
Njësia Administrative Fajza	382	380	359	363
Njësia Administrative Gjinaj	144	135	137	134
Total	1,652	1,678	1,658	1,689

Tabela 4. Të dhëna mbi skemën e NE

Kategoritë përfituese të NE	Shtator 2020		Shtator 2021		Shtator 2022		Shtator 2023	
	Nr.	Fond	Nr.	Fond	Nr.	Fond	Nr.	Fond
Familje përfituese të NE	1681	10,510,893	1670	10,413,668	1708	14,807,432	1684	16,467,425
Individë me status jetimi								
Individë viktimë të trafikimit							1	9,900

Individë viktimë të dhunës								
Prindër me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh								
a) trinjakë	1	9,000	2	18,000	2	18,000	1	9,000
b) Katënjakë								
c) Pesë e më shumë se fëmijë të lindur njëherësh								
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare	4	121,000	4	116,000	4	116,000	4	116,000
Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare	0	-			0	-	0	-
Total		5,280,444		5,660,748		7,054,338		8,500,056

Tabela 5. Të dhëna mbi familjet aplikuese për NE dhe familjet përfituese të NE

Viti	Nr. familjesh aplikojnë për NE	Nr. familje përfitojnë NE	Raporti përfitues/aplikues
Viti 2020	1697	1652	97.35%
Viti 2021	1697	1652	98.84%
Viti 2022	1675	1658	98.99%
Viti 2023	1697	1689	99.53%

Tabela 6. Të dhëna mbi familjet përfituese të NE sipas numrit të anëtarëve

Nr	Përshkrimi	Nr. familje përfitojnë NE	Nr. i anëtarëve të familjeve përfituese të NE
1	Familje me 1 anëtar	2	2
2	Familje me 2 anëtarë	47	94
3	Familje me 3 anëtarë	144	432
4	Familje me 4 anëtarë	405	1,620
5	Familje me 5 anëtarë	527	2,635
6	Familje me 6 anëtarë	327	1,962
7	Familje me mbi 6 anetare	232	1,740
	Totali	1,689	8,458

Tabela 7. Të dhëna mbi përfitimin e pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar

Përshkrimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023 (Janar-Tetor 2023)		
	Numër mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor	Numër mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor	Numër mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor
1. Para dhe tetraplegjike	45		19,458,113	43		19,175,897	46		13,830,077
i) Bashkia/qytet	21		7,288,388.31	18		7,147,280	20		5,962,095
ii) Njësitë administrative	27		12,169,725	25		12,028,617	26		7,867,982
2 Të verbër	36		7,676,962	38		7,394,746	36		3,752,683
i) Bashkia/qytet	17		865,086	15		723,978	14		251,126
ii) Njësitë administrative	28		6,811,876	23		6,670,768	22		3,501,557
3 Invalidë	328		22,881,548	520		22,599,331	527		14,792,600
i) Bashkia/qytet	198		10,308,574	182		10,167,466	192		6,459,500
ii) Njësitë administrative	350		12,572,974	338		12,431,866	335		8,333,100
4 PAK të tjerë	438		52,440,192	295		52,157,976	305		41,648,664
i) Bashkia/qytet	105		16,585,681	97		16,444,573	103		13,830,930
ii) Njësitë administrative	207		35,854,511	198		35,713,403	202		27,817,734
Total 1+2+3+4	847	-	102,456,815	896	-	101,327,949	914	-	74,024,024

Tabela8. PAK mendorë dhe fizikë sipas moshës

Njësia administrativ e	PAK mendorë			PAK fizikë			TOTAL
	Total	Mosha 0-18	Mosha 19+	Total	Mosha 0-18	Mosha 19+	
Krume	62	21	41	57	26	31	122
Golaj	55	25	30	39	21	18	94
Fajza	37	15	22	25	11	14	62
Gjinaj	14	5	9	16	8	8	30
Total 1+2+3+4	168	66	102	137	66	71	305

Tabela 9. Analiza e PAK që vazhdojnë arsimin e mesëm

Përshkrimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023 (Janar-Tetor 2023)	
	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor ALL	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor
1. Para dhe tetraplegjike						
<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
2 Të verbër						
<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
3 Invalidë						
<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
4 PAK të tjerë	3	585,630	4	798,048	6	1,042,860
<i>i) Bashkia/qytet</i>	3	585,630	4	798,048	6	1,042,860
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
Total 1+2+3+4	3	585,630	4	798,048	6	1,042,860

Tabela 10. Analiza e PAK që vazhdojnë arsimin e lartë

Përshkrimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor
1. Para dhe tetraplegjike						
<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
2 Të verbër						

<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
3 Invalidë						
<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
4 PAK të tjerë	3	878,175	7	2,094,876	5	1,303,575
<i>i) Bashkia/qytet</i>	3	878,175	7	2,094,876	5	1,303,575
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
Total 1+2+3+4	3	878,175	7	2,094,876	5	1,303,575

Tabela 11. Përfitimi i ndihmës personal

Kategoritë e PAK sipas Njësite Administrative	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023 (Janar-Tetor 2023)	
	Numër mesatar PAK përfitues të Ndihmës Personal	Fondi total vjetor	Numër mesatar PAK përfitues të Ndihmës Personal	Fondi total vjetor/ ALL	Numër mesatar PAK përfitues të Ndihmës Personal	Fondi total vjetor/ALL
1. Para dhe tetraplegjike	45.00	7,486,368	45.00	7,498,992	46	624,916
Njësia Administrative Krume	20.00	2,973,348	20.00	2,973,348	20	247,779
Njësia Administrative Golaj	11.00	2,322,132	11.00	2,334,756	12	194,563
Njësia Administrative Fajza	11.00	1,721,412	11.00	1,721,412	11	143,451
Njësia Administrative Gjinaj	3.00	469,476	3.00	469,476	3	39,123
2 Të verbër	8.00	1,343,128	8.00	1,352,832	8	112,736
Njësia Administrative Krume	2.00	338,208.00	2.00	338,208.00	2	28,184
Njësia Administrative Golaj	4.00	676,416.00	4.00	676,416.00	4	56,368
Njësia Administrative Fajza	2.00	328,504.00	2.00	338,208.00	2	28,184
Njësia Administrative Gjinaj	-	-	-	-	-	-
3 Invalidë						
Njësia Administrative Krume						
Njësia Administrative Golaj						
Njësia Administrative Fajza						
Njësia Administrative Gjinaj						
4 PAK të tjerë	70.00	35,968,092	70.00	35,457,036	70	900,789
Njësia Administrative Krume	19.00	2,740,524	19.00	2,740,524	19	228,377

Njësia Administrative Golaj	31.00	18,228,060	31.00	17,574,024	31	397,417
Njësia Administrative Fajza	16.00	10,642,848	16.00	10,642,848	16	229,555
Njësia Administrative Gjinaj	4.00	4,356,660	4.00	4,499,640	4	45,440
Total 1+2+3+4	123	44,797,588	123	44,308,860	124	1,638,441

Tabela 12. Të dhëna për situatën aktuale të fëmijëve në nevojë

Përshkrimi	Total	M	F
Fëmijë në konflikt me ligjin	4	4	0
Të shfrytëzuar për punë	0	0	0
Viktima të trafikimit/të mundshme trafikimi	0	0	0
Jetim	0	0	0
Fëmijë 0-15 vjeç në familje me NE	870		
Fëmijë 15 vjeç e lart në familje me NE	448		
Fëmijë me AK	135	68	67
Fëmijë pa kujdes prindëror	-	-	-
Fëmijë viktima të dhunës	14	9	5
Fëmijë në shërbim kujdesi alternative	4		4
Nr. total i fëmijëve në kujdes rezidencial në fund të vitit	0	0	0
Nr. fëmijëve në shtëpinë e foshnjës në fund të vitit	0	0	0
Nr. i fëmijëve me AK në kujdes rezidencial publik (në të gjitha institucionet) në fund të vitit	0	0	0
Fëmijë në situatë rruge	0	0	0
Fëmijë që nuk shkojnë në shkollë	-	-	-
Total	1475		

Tabela 13. Të dhëna mbi dhunën

Njësiti administrative	Raste të dhunës me UM				Raste të dhunës me UM përfitojnë pagesë			
	Vitit 2020	Vitit 2021	Viti 2022	Shtator 2023	Vitit 2020	Vitit 2021	Viti 2022	Shtator 2023
Krumë	0	4	2	2	0	0	0	0
Golaj	1	2	1	1	0	0	0	0
Fajza		2		3	0	0	0	0
Gjinaj					0	0	0	0
Total	1	8	3	6	0	0	0	0
Total 2020-				18				0

2023

Tabela 14. Strehimi/bonusi i qirasë

	Aplikime		Përfitues të bonusit të qerases gjatë viteve							
	Nr. total gjatë vitit	Femra në %	Përfitues total gjatë vitit	Nga skema e NE	PAK	Jetim	Gra k/familjare	Viktima të dhunës/urdhërmbrotje	Etni rom/egjiptian	Të tjerë
Viti 2020	95		62							
<i>i) Bashkia Has</i>										
<i>ii) Njësitë Adm.</i>										
<i>Total i+ ii</i>										
Viti 2021	121		89							
<i>i) Bashkia Has</i>										
<i>ii) Njësitë Adm.</i>										
<i>Total i+ ii</i>										
Viti 2022	121		100							
<i>i) Bashkia Has</i>										
<i>ii) Njësia Adm.</i>										
<i>Total i+ ii</i>										
Viti 2023	145		95							
<i>i) Bashkia Has</i>										
<i>ii) Njësia Adm.</i>										
<i>Total i+ ii</i>										

Tabela 15 Të dhëna për moshën e tretë

Viti	Të moshuar sipas Njësive Administrative				Total
	Krumë	Golaj	Fajza	Gjinaj	
Të moshuar që kërkojnë shërbim në familje	185	132	52	18	387
Nr I të moshuarve që kërkojnë shërbim në	197	125	48	25	

qender ditore					395
Nr I të moshuarve qe kërkojnë shërbim rezidencial	0	0	0	0	0
Nr I të moshuarve që jetojnë vetëm dhe që përfitojnë NE	5	3	3	3	14
Të moshuar të vetmuar	3	5	4	1	13
Të moshuar të sëmurë	16	22	17	7	62
Të moshuar të braktisur	0	0	0	0	0
Total	54	71	55	24	204

Tabela 16. Tabela e shërbimeve ekzistuese dhe nevojat për shërbime

Shërbime për çdo grup në nevojë	Shërbime ekzistuese			Shërbime të kërkuara	
	Numër shërbimesh	Numër përfituesish	Numër përfitues/ totalin e popullatës sipas grupmoshës	Shërbimi	Nr. përfituesish
1-Çerdhe	0	0	0	3 çerdhe, një për çdo NJA	90 fëmijë 0-4 vjeç
2-Shërbime për të rinjtë	0	0	0	Qendër rinore	200 fëmijë dhe të rinj
3-Shërbime për fëmijët	0	0	0	Qendër ditore për fëmijën dhe familjen në Krumë	60 fëmijë 6-14 vjeç dhe 30 familje
4-Nxitje e formimit profesional për të rinjtë dhe të rejtat në zonat rurale	0	0	0	Financimi i shpenzimeve të transportit për të rinjtë dhe të rejtat, banues në zonat rurale, që ndjekin kurse të formimit profesional	10 të rinj 15-25 vjeç
5- Qendër shërbimi e specializuar	1	120	N/A	Shërbim të specializuar (logopedi dhe fizioterapi)	i) 10 fëmijë 0-4 vjeç; ii) 10 fëmijë 5-18 vjeç; iii) 10 rritur mbi 18 vjeç

6-Qendër emergjence për rastet e dhunës dhe trafikimit	0		0	Qendër emergjence për rastet e dhunës dhe trafikimit për të gjithë Bashkinë Has	10 raste në vit
7-Qendra komunitare për moshën e tretë	0	0	0	4 (Katër) Qendra komunitare për moshën e tretë, një në çdo NJA	800 të moshuar mbi 60 vjeç
8- Qendër shërbimi multidisiplinare për grupet në nevojë	0	0	0	3 qendra, një në çdo NJA	120-160 individë në nevojë
9-Qender shërbimi lëvizës për AK	0	0	0	1 (një) qendër lëvizëse: i) PAK	i) 35-40 PAK në javë përfitojnë shërbime